



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 403/7 prot.

Tiranë, më 8.8.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.7.2019, është njoftuar vendimi nr. 161, datë 18.6.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita, gjyqtar/Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Pas njoftimit të këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.7.2019, është depozituar akti “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr.161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, është gjyqtar prej vitit 2001 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit/Kryetar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vitet 2001-2002, gjyqtar/Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, në vitet 2002-2010, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës 2010-2013, gjyqtar/Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në vitet 2013 - në vazhdim.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Kastriot Selita, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve: atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si KLD), nga të cilat rezultojnë se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Kastriot Selita*”¹, ka referuar për subjektin se:

- i. Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit², i ka referuar Komisionit “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

3.3 KLD, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale³ nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku, Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo elemente që cenojnë etikën e subjektit të rivlerësimit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për 4 pasuri të paluajtshme; 1 automjet, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet, Komisioni ka arritur në përfundimin se: “...subjekti i rivlerësimit ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “Vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaramet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D, të aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016. Hetimi i thelluar administrativ i Komisionit për burimet e bashkëshortes para martese apo konstatimi i pasaktësisë së saj, në një nga pasuritë e deklaruara dhe që nuk cenonte burimin e ligjshëm, nuk passjell pasojë ligjore për subjektin e rivlerësimit e, për

¹ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017.

² Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017 dhe nr. *** prot., datë***.5.2018.

³ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2018.

rrjedhje, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë” (f. 77 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë, edhe pas kryerjes se hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLD-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, gjyqtar/Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në dispozitivin e vendimit, Komisioni ka vendosur transferimin e dosjes që i përket çështjes administrative me palë ndërgjyqëse: paditës shtetasin ***.*** dhe të paditur Presidentin e Republikës, përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pranë organit përkatës për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore për subjektin e rivlerësimit. Ndërkohë, anëtari në pakicë i trupit gjykues të Komisionit, në mendimin e pakicës, ka argumentuar qëndrimin e tij në lidhje me ekzistencën e kriterëve ligjore për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, mbështetur në kriteret e kontrollit të pasurisë dhe aftësive profesionale.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

6. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “C⁴”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65/2,⁵ të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 24.7.2019, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. ***, “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita (bashkëlidhur këtij ankimi).

7. Objekti i këtij rekomandimi është hetimi i mëtejshëm për vlerësimin dhe përfundimet e Komisionit për të tria kriteret, duke u ndalur në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita.

II.A. Gjetjet e ONM-së lidhur me kriterin e pasurisë janë si në vijim:

8. Për secilën nga shumatat monetare, 30.000 euro, 61.758 euro dhe shuma 20.000 euro, përfutur nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit, znj. ***.****) nga babai i saj, mbetet i paqartë nëse këto do të kualifikohen si dhurim nga babai dhe nëse kualifikohen si të tilla,

⁴ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁵ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’ia paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

këto shuma a duhet t'i nënshtrohen pagesave të detyrimeve tatimore, sipas ligjit nr. 8438/1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar).

9. *Për shumën 2.9 milionë lekë, përfutuar nga subjekti në vitin 2006, pas divorcit*, bazuar në vendimin e gjykatës për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, nuk është hetuar plotësisht burimi i krijimit të kësaj shume.
10. *Pagesa e detyrimeve tatimore, shumë vite më vonë se afati i përcaktuar*. Mbetet e paqartë nëse tatimet e paguara më vonë se data e përcaktuar në ligj duhet të konsiderohen si shkak që legjitimojnë të ardhurat për të cilat ato paguhen, duke qenë se bashkëshortja e subjektit i ka paguar vetëm disa ditë përpara dorëzimit të deklaratës Vetting në ILDKPKI (2017), për shitjen e një aseti në vitin 2007.
11. *Mosdeklarimi i huas në shumën 23.000 euro, marrë nga shtetasi ***.***, në D-Vett*. Duke qenë se kjo shumë është burim financiar fillestar për apartamentin e bashkëshortes me sip. 102 m² ndodhur në ***, Tiranë, të hetohet mundësia financiare e huadhënësit për të dhënë hua këtë shumë.
12. Hetimi lidhur me rivlerësimin e pasurive të paluajtshme në pronësinë individuale të bashkëshortes së subjektit, në vitin 2012, bazuar në ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011, "*Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor*" (të ndryshuar).
13. Mospërputhje e vlerave të kostove të ndërtimit (3 të tilla) për objektin, shtëpi banimi 2 kt+ papafingo me sip. totale ndërtimi 268.2 m², në ***, Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortes.
14. Mospërputhje e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 94.4 m² nga shoqëria "****" sh.p.k.
15. Mospërputhje në analizën financiare, të elementeve si vijon:
 - (i) Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhura të bashkëshortes për periudhën 1999-2004, për të cilën nuk është e qartë nëse janë paguar apo jo detyrimet tatimore;
 - (ii) Komisioni duket se ka përfshirë në analizën financiare për të njëjtën pasuri (truall dhe ndërtimi në ***, Tiranë), të ardhurat nga firmat piramidale, të investuara nga babai i bashkëshortes, për të cilat nuk dihet burimi dhe nëse janë të ardhura të ligjshme;
 - (iii) Pasaktësi të tjera në analizën financiare të Komisionit, mbi të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të personit të lidhur;
 - (iv) Trajtimi i këtyre çështjeve, dhe të tjera të mundshme, si niveli i diskutueshëm i shpenzimeve të jetesës dhe ndikimi i tyre në analizën financiare.

II.B. Për kriterin e aftësive profesionale

Ka dyshime nëse vlerësimi i shumicës "i aftë" për subjektin e rivlerësimit është i përshtatshëm, duke pasur parasysh faktet e këtij rasti. Në disa çështje gjyqësore, ku subjekti, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ose të relatorit, ka vepruar në situatën e konfliktit në dukje të interesit, pasi:

- (i) Subjekti ka kryer dy transaksione shitblerje me palët në gjykim;
- (ii) Subjekti nuk ka paraqitur dorëheqje nga proceset gjyqësore⁶, ku një nga palët janë organet tatimore, konsideruar faktin që personi i lidhur, bashkëshortja e tij, ka një pozitë të rëndësishme dhe me influencë.

II.C. Sipas vlerësimit të ONM-së, ankimi i këtij vendimi do të mundësojë që Kolegji i Apelit:

- (i) Të ndërmarrë hapa të mëtjshëm në kuadër të hetimit për çështje që nuk janë hetuar në mënyrë të plotë ose gjithëpërfshirëse nga Komisioni;

⁶ Për më tepër, referohuni aneksit nr.1 të rezultateve të hetimit, si dhe rezultateve shtesë të hetimit, në dosjen e KPK-së.

- (ii) Të kryejë një analizë të saktë financiare, ku të vlerësohen në mënyrën e duhur dhe të qartë të gjitha çështjet në fjalë;
- (iii) Të vlerësojë çështjet që lidhen me pasuritë, të cilat mund të kenë një ndikim gjithashtu në raste të tjera të ngjashme (si taksimi i dhurimeve në vlerë monetare, detyrimet tatimore që nuk paguhen në kohë ose e drejta për të rivlerësuar pasuritë e paluajtshme);
- (iv) Të kryejë një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të aftësive profesionale;
- (v) Të marrë në konsideratë çdo çështje të mundshme të pazgjidhur, që mund të ketë ndikim në vlerësimin e përgjithshëm të subjektit të rivlerësimit.

III. Shkaqet e ankimit

- 16.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).
- 17.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).
- 18.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
- 19.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.
- 20.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, marrë në konsideratë rekomandimin e ONM-së, provat e administruara nga Komisioni, vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
- 21.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon vlerësimit të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- 22.** Sa më sipër, referuar dhe përmbajtjes së rekomandimit të paraqitur nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtar të ONM-së, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë, e për rrjedhojë përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara.

23. Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, persona të tjerë të lidhur, kryerjen e një analize të re financiare, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, nëpërmjet të ardhurave të ligjshme, sipas urdhërimit të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
24. Po ashtu, për sa i takon vlerësimin të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në kërkesat e nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Duket se në vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni ka zgjedhur të mbajë një qëndrim të fragmentarizuar për çdo çështje të shqyrtuar, pa marrë në analizë përfundimtare, gjithëpërfshirëse, të gjitha gjetjet e evidentuara në hetimin administrativ të dokumentacionit të shortuar, paraqitur nga subjekti dhe denoncimet e publikut.
25. Komisioneri Publik, në vijimësi të qëndrimeve të mbajtura nga ky institucion në ushtrimin e ankimeve, nëpërmjet të cilave kërkohet hetimi i mëtejshëm i kritereve të rivlerësimit, referuar përmbajtjes së pikës 2 të nenit 4, pikës 1 të nenit 59 dhe pikës 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, çmon se edhe kontrolli i figurës së subjektit, bazuar në nenin Dh të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V të ligjit nr. 84/2016, duhet t'i nënshtrohet hetimit nga ana e Kolegjit, për të arritur eventualisht në një vendimmarrje për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit.
26. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik konstaton se procesi i hetimit i Komisionit, për të tria kriteret e rivlerësimit, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016.
27. Komisioneri Publik vlerëson se nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankim), do të bëhet e mundur që këto mangësi të vërejtura gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit, të mund të riparohen gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Kolegjit.
28. Bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionit Publik ndaj vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

III.A. Analiza e shkaqeve të ankimit

II.A.1 Kontrolli i pasurisë

29. Pasuritë nga subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, janë deklaruar fillimisht në “*Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie*” (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dorëzuar në ILDKPKI, më datë ***.3.2004, deklaratat periodike për vitet 2003 - 2016 dhe në *Deklaratën “Vetting”* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.) dorëzuar në ILDKPKI, më datë ***.1.2017. Pasuritë e deklaruara janë si vijon:
30. **Pasuria nr. 1. Në D-Vett deklarohet:** “Apartament” me sipërfaqe 124.91 m², nr. pasurie ***, Z. K. ***, vol. ***, f.***, rr. “***.***”, ***, Tiranë. Pasuria e blerë nga pala shitëse, znj. ***.*** dhe z. ***.***, për vlerën 177.370 euro, me kontratë shitje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2015⁷, me pjesë takuese 50%, në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten znj. ***.***. Subjekti ka

⁷ Në nenin 4 të kontratës parashikohet mënyra e likuidimit me dy këste: (i) shuma 92.370 euro do të derdhet në llogarinë e noteres brenda një jave dhe (ii) diferenca prej 85.000 euro do të likuidohet me kredinë që do të marrë pranë ***.

deklaruar dhe *shpenzime për mobilim* për pasurinë 1, në vlerën 21.354 euro me kontribut të përbashkët me bashkëshorten prej 50% secili.

31. Në DV-2015 dhe në D-Vett deklarohet si burim i krijimit të pasurisë së bashku me mobilimin: (i) kredi bankare e marrë nga *** Bank, në shumën 85.000 euro; (ii) kursime nga të ardhurat familjare të vitit 2015, në shumën 3.724 euro; (iii) të ardhurat nga shitja e apartamentit⁸ me sipërfaqe 94.6 m², në adresën rr. “****.***”, pallatet “****” Tiranë, në shumën 110.000 euro. (Për blerjen e apartamentit me sip. 94.6 m², deklarohet si burim, të ardhurat e bashkëshortes nga shitja e një shtëpie banimi 2 kate + papafingo me sip. totale ndërtimi 268.2 m² në ***, Tiranë, në shumën 220.000 euro).

Në vijim do të trajtohet secili prej zërave të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë 1.

31.1 Për kredinë bankare. Me dokumentacionin e përcjellë nga *** Bank⁹ Komisionit, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e bashkëhuamarrësve, kanë marrë hua në shumën 85.000 euro pranë kësaj banke, me kontratë kredi bankare hipotekore nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2015. Nga verifikimet e llogarisë së bashkëshortes së subjektit, pranë *** Bank, pas disbursimit të kredisë, rezulton se kjo shumë është transferuar në llogarinë e noteres në datë ***.12.2015, me përshkrimin “*sipas kontratë shitje nr. ***, datë ***.12.2015*”.

31.2 Për kursimet në shumën 3.724 euro, të ardhura familjare në vitin 2015. Nga analiza financiare në raport me të ardhurat, në kuadër të verifikimit të aftësive financiare për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të mjaftueshme për të blerë pasuritë, për të realizuar kursimin, si dhe për të kryer shpenzimet e deklaruara në deklaratat e interesave vetjake pasurore, përkatësisht në vitin 2015.

31.3 Në lidhje me burimin e deklaruar në vlerën 110.000 euro, të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 94.6 m², në adresën rr. “****.***”, pallatet “****”, Tiranë, nga aktet e administruara nga korrespondenca zyrtare e Komisionit me ZVRPP Tiranë¹⁰, rezulton se janë kryer disa transaksione të mëparshme në rend kronologjik si vijon:

- (i) Me kontratë shitblerje toke bujqësore nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2002, babai i bashkëshortes së subjektit, z. ***.***, ka blerë nga pala shitëse, z. ***.*** dhe znj. ***.***, tokë bujqësore 330 m², ndodhur në ***, Tiranë, për vlerën 600.000 lekë. Me vendimin e KRRt-së, Komuna *** nr. ***, datë ***.4.2004, mbi këtë truall është miratuar ndërtimi i objektit shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sipërfaqe totale ndërtimi 268.2 m². Referuar aktit të kolaudimit, shtator 2004, përcaktohet se punimet kishin filluar në datë 1.5.2004 dhe se objekti ishte përfunduar në kohën e kryerjes së aktit të kolaudimit. Pasuria e përfutur është regjistruar në titull pronësie të babait të subjektit, z. ***.***, në datë 26.12.2006.
- (ii) Me kontratë shitblerje me rezervë pronësie me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2008, z. ***.***¹¹ i ka shitur z.***.***, pasurinë (truall + ndërtësë) për vlerën 220.000 euro, nga të cilat 20.000 euro i janë paguar paraprakisht me kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.5.2008.
- (iii) Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***, ka blerë sipas kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2008 për shumën 61.758 euro, nga shoqëria “****” sh.p.k, apartamentin me sip. 94.6 m², ndodhur në adresën rr. “****.***”, pallatet “****”, Tiranë.

⁸ Apartamenti ka qenë në pronësi 100% të bashkëshortes znj. ***.***.

⁹ Me shkresë përgjigje nr. *** prot., datë ***.2.2018, protokolluar pranë KPK-së, me nr. *** prot. datë ***.2.2018.

¹⁰ Shkresë e ZVRPP-së Tiranë nr. *** prot., datë ***.2.2018, shkresë e ZVRPP-së Tiranë nr. *** prot., datë ***.2.2018; shihni në dosje të ILDKPKI-së, shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2017 dhe dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP Tiranë për origjinën e shtëpi banimi 2kt+ppf në ***, Tiranë.

¹¹ Në kontratë kanë dhënë pëlqimin bashkëshortja e z. ***.***, znj. ***.*** dhe z. ***.***.

(iv) Pas rivlerësimit të apartamentit¹² me sipërfaqe 94.6 m², bashkëshortja e subjektit i ka shitur këtë apartament z. ***.*** me kontratë shitblerje pasuri të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.10.2015, për shumën 110.000 euro.

32. Lidhur me transaksionet e kryera si më sipër, znj. ***.***, bashkëshortja e subjektit, si personi që ka mbartur detyrimin për deklarimin e interesave private pasurore¹³, ka deklaruar si vijon:

32.1 Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, me nr. indeksi ***, dorëzuar në ILDKPKI në datë ***.4.2006, nga bashkëshortja e subjektit, znj.***.*** deklarohet: (i) tokë 330 m² mbi të cilën ndodhet shtëpia 268.2 m², Komuna ***, ***, Vlera 660.000 lekë, pjesa takuese 25%. **Burimi i krijimit** të pasurisë nuk specifikohet. (ii) “Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sipërfaqe 268.2 m², Komuna ***, ***, Tiranë. Vlera 5.000.000 lekë, pjesa takuese 25%. **Burim krijimi** për shtëpinë deklarohen dy zëra: (a) të ardhurat nga shitja e shtëpisë së mëparshme; (b) të ardhurat familjare.

32.2 Në DV-2008, bashkëshortja e subjektit, znj. ***.***, ka deklaruar apartamentin me sip.106 m² në rr. “***.***”, Tiranë, blerë në vlerën 62.000 euro, në pronësi të saj. **Burim krijimi** deklarohen: të ardhurat në shumën 220.000 euro nga shitja shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sipërfaqe totale ndërtimi 268.2 m² në ***, Tiranë, në pronësinë e përbashkët familjare.

32.3 Në DV-2015, bashkëshortja e subjektit, znj.***.***, ka deklaruar blerjen e apartamentit me sipërfaqe 124.91 m,² në rr. “***.***”, ***, Tiranë, për vlerën 177.370 euro në bashkëpronësi me subjektin, 50% pjesë takuese secili. **Burim krijimi** deklarohen: (i) shuma 110.000 euro, e ardhur e siguruar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 94.6 m² në rr. “***.***”, Tiranë, për vlerën 110.000 euro.

33. Nga verifikimi i këtyre akteve, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, një pjesë e mjeteve financiare për blerjen e apartamentit me sip.124.91 m² në rr. “***.***”, ***.***, aktualisht në titull pronësie të subjektit dhe personit të lidhur, kanë si origjinë fillestare gjendjen pasurore dhe financiare të bashkëshortes së subjektit dhe familjes së saj, në momentin e krijimit të asetit të parë që kjo familje ka pasur në pronësi, shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë.

34. Nisur nga arsyetimi i vendimit (f.10), Komisioni e ka kualifikuar bashkëshorten e subjektit “*person të lidhur*”¹⁴ dhe prindërit e saj “*person tjetër të lidhur*”¹⁵, me subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita, që mbartin detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë familjare.

35. Marrë në konsideratë deklaratimet e bëra nga personi i lidhur dhe referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit datë 14.8.2018, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të asetit të parë në pronësi të familjes ***, shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë, Komisioni ka analizuar të ardhurat e familjes *** deri në vitin 2004.

35.1 Lidhur me të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm (Peshkopi), deklaruar si një nga zërat për krijimin e pasurisë, shtëpi me sip. 268.2 m², Komuna ***, ***. Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Dibër, me shkresën nr. *** prot., datë ***.4.2018, rezulton se me kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme, nr. *** rep., nr. *** kol., datë

¹² Apartamenti është rivlerësuar në shumën 17 milionë lekë, në bazë të aplikimit nr. ***, datë ***.12.2011, në ZVRPP Tiranë.

¹³ Ka filluar detyrën në organet tatimore në funksionin e Inspektore në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë, datë ***.4.2006 dhe ka deklaruar pranë ILDKPKI-së, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

¹⁴ Sipas nenit 3, pika 13, të ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Referuar nenit 3. pika 14. të ligjit nr. 84/2016 dhe duke qenë se janë bashkëpronarë dhe kanë deklaruar përfitime monetare nga shitja e shtëpi banimi me sip. 268.2 m² në ***, Tiranë.

.10.1995, z. ***., znj.***.*** dhe znj. ***.***, në cilësinë e palës shitëse, i kanë shitur shtetasit z. ***.*** apartamentin 2+1, në lagjen “***.***”, Peshkopi, për vlerën 850.000 lekë. Referuar përgjigjeve të subjektit të datës 14.11.2018, kjo shumë ka shërbyer si burim për kapitalin fillestar për investimin e z.***.*** në shoqëritë huamarrëse “***” dhe “***”. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. *** prot., datë ***.11.2018, konfirmohet që shuma totale e tërhequr nga ***.*** nga shoqëritë huamarrëse “***” dhe “***” është në shumën 2.069.384 lekë.

35.2 Lidhur me të ardhurat familjare të realizuara deri në vitin 2004, periudhë që përkon me kohën e përfundimit të ndërtimit të shtëpisë së banimit në ***, Tiranë. Gjatë hetimit administrativ, në dosjen e Komisionit janë administruar ndër të tjera:

- (i) Shkresë nga ISSH nr. *** prot., datë ***.2.2018, për të ardhurat e realizuara nga ***.*** dhe ***.***;
- (ii) Vërtetim nr. *** prot., datë ***.11.2018, i Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore;
- (iii) Shkresë nga ISSH nr. *** prot., datë ***.11.2018, që vërteton të ardhurat e realizuara nga ***.*** nga punësimi në subjektet tregtare, “***” sh.p.k, “***” sh.p.k, “***.***” sh.p.k, “***” sh.p.k, si dhe fondacioni “***.***.***”;
- (iv) Shkresë nga DRT Tiranë, me nr. *** prot., datë ***.11.2018, që informon për tatimin mbi të ardhurat, tatimin në burim, tatim fitimi i paguar nga subjektet tregtare, ku ka qenë e punësuar bashkëshortja e subjektit, znj. ***.***;
- (v) Shkresë nga DRT Tiranë, nr. *** prot., datë ***.2.2018, që informon lidhur me qarkullimin e realizuar nga aktiviteti privat i znj. ***.***¹⁶, për periudhën 2003-2006;
- (vi) Lista e pagave të deklaruara për punonjësit, nga shoqëritë “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., në ISSH.
- (vii) Listat e pagave nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., administruar në ISSH për periudhat prill 2000 - gusht 2001, si dhe “***” sh.p.k. për vitin 2002;
- (viii) Vërtetimi nga ISSH nr. *** prot., datë ***.3.2007.

36. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm, të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë shtëpi me sipërfaqe 268.2 m², konstatohet se janë përfshirë të ardhurat e familjes *** për periudhën 1997-2005. Referuar provave të administruara në dosjen e Komisionit rezulton, ndër të tjera, edhe një shkresë nga shoqëria “***” sh.p.k., nr. *** prot., datë ***.12.2018 (hartuar dhe depozituar gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit), ku pretendohet se pagesa e situacioneve për ndërtimin e objektit shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268.2 m², është kryer në vitet 2003-2004. Sipas shkresës së lartpërmendur, konkretisht, shuma 4.377.090 lekë është paguar deri në datë 31.12.2003 dhe pjesa tjetër e mbetur, prej 377.022 lekë, është paguar deri në datë 8.7.2004.

37. Nisur nga ky fakt i dalë gjatë hetimit administrativ, në analizën e burimeve financiare, referuar dhe rekomandimit të ONM-së datë 24 korrik 2019, Komisioni do të duhet të përllogariste të ardhurat e familjes *** deri në korrik 2004.

38. Rezulton se, referuar burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për mbulimin e kostove të ndërtimit për shtëpinë e mësipërme dhe blerjen e truallit, Komisioni, bazuar në analizën financiare, ka arritur në përfundimin se familja *** ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme.¹⁷

39. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për pasurinë shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë, qëndrojnë në katër elemente: (i) mospërputhje e vlerës së kostos së ndërtimit, që duket se është

¹⁶ Regjistruar si person fizik me objekt veprimtarie “Konsulencë”.

¹⁷ Shihni f.16 të vendimit.

reflektuar në analizën financiare të Komisionit, krahasuar me atë në dokumentacionin provues sjellë nga subjekti; (ii) justifikimi i krijimit të kësaj pasurie¹⁸ me burime të ligjshme për të ardhurat e ligjshme në shumën 1.630.035 lekë të znj. ***,***, nga fondacioni “***.***.***” Albania; (iii) përlllogaritja e shpenzimeve të mobilimit të pasurisë shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), si dhe shpenzime qiraje për familjen *** nga viti 1996-2004; (iv) metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës.

40. Lidhur me mospërputhjet e vlerës së kostos së ndërtimit. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, personi i lidhur ka deklaruar: shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë, në vlerën 5 milionë lekë. Ndërkohë, në përgjigjet e tij të datës 14.11.2018, dërguar Komisionit gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: “...vlera e ndërtimit është 4.754.112 lekë. Kjo shumë i është paguar cash shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k. gjatë periudhës 2003 – 2004. Shuma e deklaruar në DV 2005 nga bashkëshortja në shumën 5 milionë lekë përbëhet nga shuma 4.754.112 lekë (vlera e ndërtimit sipas vlerës së projektit), si dhe shuma 245.888 lekë që ka të bëjë me pagesat e ndryshme, të cilat janë bërë për projektim (arkitekturor, inxhinierik, elektrik, hidraulik etj.)...”. Në vijim të këtij arsytimi të subjektit të rivlerësimit, shoqëria “***” sh.p.k., me shkresë nr. *** prot., datë ***.12.2018, të cituar edhe më lart në këtë ankim, ka paraqitur pranë Komisionit dy situacione punimesh, si dhe dy fatura tatimore¹⁹ me vlerë totale 4.754.112 lekë.

40.1 Konstatohet po ashtu se Komisioni, edhe pse në arsyetimin e vendimit të tij (f.12) ka vlerësuar se kostoja e ndërtimit ka qenë 24.446 lekë/m² x 268.2 m² me vlerë totale 6.556.417,2 lekë²⁰, në analizën financiare ka reflektuar vlerën e kostos së ndërtimit për këtë pasuri në shumën 4.754.112 lekë.

40.2 Vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, datë 15.8.2018, ka paraqitur dokumentacion mbështetës për pagesat tatimore mbi ardhurat e përfituara nga shitja e asetit në vlerën 220.000 euro. Sipas mandatit të *** Bank, datë ***.7.2008, z. ***,*** ka paguar shumën 1.902.280 lekë, me përshkrim: “pagesë taksë për shitblerje shtëpie 10% të fitimit kapital për ZRPP Tiranë”. Bashkëlidhur këtij veprimi arke, është edhe një fletë përlllogaritjeje e kësaj takse nga ana e ZVRPP-së Tiranë, format i thjeshtë A4, nga e cila rezulton se kostoja e ndërtimit të shtëpisë, si çmim reference, është vlerësuar 27.000 lekë/m² x 268.2 m², me vlerë prej 7.241.400 lekë, që së bashku me vlerën e truallit prej 600.000 lekësh, sipas kontratës përkatëse të shitblerjes, shkojnë në total në shumën 7.841.400 lekë.

40.3 Në rast se bazuar në këtë ankim, nga ana e Kolegjit do të vendoset të kryhet një analizë e re financiare, referuar koston së ndërtimit, të përlllogaritur bazuar në legjislacionin në fuqi, prej 7.241.400 lekë, zëri i përlllogaritur “pasuri” në analizën e Komisionit, do të rritej me 2.487.288 lekë, çka do të çonte në një rezultat të ndryshëm nga ai i Komisionit, në lidhje me mbulimin me të ardhura të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

41. Lidhur me të ardhurat nga fondacioni “*.***.***” Albania.** Për të ardhurat e realizuara nga znj.***.***, për periudhën 1999-2004, në shumën 2.954.608²¹ lekë, na rezulton se në

¹⁸ Shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë.

¹⁹ Faturë tatimore shitje nr. ***, datë ***.12.2003, me vlerë 3.188.562 lekë dhe faturë tatimore shitje nr. ***, datë ***.07.2004, me vlerë 1.565.550 lekë, të panëshkruara nga blerësi, z. ***,***.

²⁰ Bazuar në udhëzimin nr. 1 datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, i vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit ‘K’”.

²¹ Kjo shumë përfshin të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 130.573 lekë, të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 69.000 lekë, të ardhurat e realizuara si person fizik, për periudhën 2003-2004, në shumën 1.125.000 lekë, si dhe të ardhurat nga fondacioni “***.***.***” Albania.

analizën financiare të kryer nga Komisioni janë përfshirë në këtë shumë edhe të ardhurat nga punësimi i saj në fondacionin “***.***.***” prej 1.630.035²² lekë.

Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, personi i lidhur, znj.***.***, ka deklaruar të ardhura për periudhën 2002-2004 nga fondacioni “***.***.***” Albania, në shumën 1.980.000 lekë.

41.1 Gjatë hetimit administrativ është administruar nga ana e Komisionit, shkresa e ISSH-së nr. *** prot., datë ***.11.2018, ku parashtrohet se për “*subjektin juridik “***.***.***”, për periudhën korrik 2000 deri në shkurt 2004, nuk figuron në listëpagesa emri i ***.***.***”.*

41.2 DRT Tiranë, me shkresë nr. *** prot., datë ***.11.2018, ka informuar Komisionin se: “*...subjekti ‘***.***.***’ Albania ka kryer pagesa Tatimi në Burim për Shërbime Konsulente, për periudhën 2002-2004, në shumat: 119.552 lekë, në vitin 2003 dhe 61.563 lekë, në vitin 2004. Lidhur me këto pagesa tatimi në burim, nuk janë të specifikuara në përshkrim apo të deklaruar nga shoqëria se kujt individit i takon pagesa e tatimit në burim”.*

41.3 Për të provuar marrëdhënien e shërbimit me fondacionin “***.***.***” Abania, vetë subjekti i rivlerësimit u ka bashkëlidhur përgjigjeve të datës 14.8.2018, një kontratë “Service Agreement”²³, lidhur mes “***.***.***” Abania dhe znj. ***.***, datë ***.1.2004, me afat nga ***.1.2004 deri në ***.12.2004. Në nenin 4 të kësaj kontrate parashikohet se “*...znj. ***.***, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, duhet të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga kjo marrëdhënie”.*

41.4 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit **barrën e provës** për të paraqitur prova ose të shpjegojë të kundërtën “*...për mospërputhjet në dukje lidhur me të ardhurat referuar dokumentacionit ku personi i lidhur ka ofruar shërbimin, dhe informacionit të konfirmuar nga organet tatimore dhe sigurimet shoqërore”.*

41.5 Në shpjegimet e datës 16.4.2019, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se “*... kontrata e vetme që disponon znj. ***.*** për ofrimin e shërbimit ndaj fondacionit “***.***.***” Albania është kontratë “Service Agreement”, datë ***.1.2004, me afat nga ***.1.2004-***.12.2004. Znj. *** ka ofruar shërbime që në vitin 2002, deri në mbylljen e këtij fondacioni (2004), por jo për të gjitha vitet i disponojmë kontratat, kjo për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar”.*

41.6 Në përfundim, në analizën financiare të Komisionit, konstatohet se zëri “*të ardhurat nga pagat*” të znj. ***.***, për periudhën 1999-2004, është në vlerën 2.954.608 lekë, duke i konsideruar si të ardhura të ligjshme shumën e përfituar nga fondacioni “***.***.***” Albania, prej 1.630.035 lekë.

42. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nga gjendja e akteve në dosje, nuk rezulton se është paraqitur dokument justifikues për të vërtetuar ofrimin e shërbimit nga znj. ***.*** pranë fondacionit “***.***.***” Albania, për periudhën 2002-2003, duke mbetur thjesht në nivel deklarativ. Referuar edhe rekomandimit të ONM-së, datë 24.7.2019, vlerësojmë se nuk është përmbushur detyrimi kushtetues dhe ligjor i hetimit të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme në shumën 1.630.035 lekë, referuar pikës 3 të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

42.1 **Në rast se bazuar në këtë ankim, nga ana e Kolegjit do të vendoset të kryhet një analizë e re financiare**, në qoftë se në interpretim të ekzistencës së burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme nuk do të përfshihej shuma e përfituar nga fondacioni

²² Komisioni e ka llogaritur këtë shumë nisur nga shuma e tatimit në burim të paguar nga fondacioni “***.***.***” Albania, për periudhën 2003-2004, por që nuk ka specifikuar se kujt individit i përket pagesa e këtij tatimi në burim.

²³ Kontratë Shërbimi.

“***.***.***” Albania, zëri “të ardhura nga paga” për znj.***.***, për periudhën 1997-2004 do të ndikonte në vlerën 1.630.035 lekë.

43. *Lidhur me përlogaritjen e shpenzimeve të tjera*

43.1 *Shpenzime qiraje.* Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2018, i konfirmon Komisionit, se familja *** më datë ***.3.1996, ka ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Peshkopi në Njësinë Bashkiake nr. ***, Tiranë.

43.2 Nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, nuk na rezulton që të jetë hetuar lidhur me shpenzime të mundshme qiraje të familjes ***, për periudhën mars 1996 deri në korrik 2004²⁴, kohë në të cilën ka përfunduar ndërtimi i shtëpisë së banimit (268.2 m²) në ***, Tiranë, në pronësi të tyre.

43.3 *Shpenzime mobilimi.* Nga hetimi administrativ i Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është pyetur lidhur me shpenzimet e kryera për mobilimin e shtëpisë së banimit (268.2 m²) në ***, ku familja *** ka jetuar në periudhën 2004-2008.

43.4 **Në rast se bazuar në këtë ankim, nga ana e Kolegjit do të vendoset të kryhet një analizë e re financiare,** përfshirja e këtyre vlerave të pahetuara nga Komisioni do të ndikonte në zërin “shpenzime” të analizës financiare, për sa i përket mbulimit me burime të ligjshme të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie²⁵.

44. *Lidhur me metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës.* Komisioneri Publik vlerëson se ndikim në analizën financiare të kryer, ndër të tjera, edhe për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme për pasurinë shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²) ka edhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës²⁶. Në vendimin e Komisionit (f.16), konstatohet se shpenzimet e jetesës për familjen ***²⁷ janë llogaritur në shumën 1.440.000 lekë për periudhën 1997-2002 dhe 1.285.714 lekë për periudhën 2003-2004.

44.1 Nisur nga sa më lart, nuk rezulton e qartë metodologjia e përdorur nga Komisioni, për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes *** për periudhën para dhe pas vitit 2003. Në këto rrethana, do të ishte i nevojshëm interpretimi/orientimi i Kolegjit, mbi metodologjinë e analizës financiare që do të duhet të përdoret për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën përpara vitit 2003 dhe pas këtij viti²⁸, nisur dhe nga praktikat e deritanishme në vlerësimin e kriterit të pasurisë (analiza financiare) nga Komisioni dhe Kolegji.

45. **Pasuria nr.2. Në D-Vett deklarohet:** “Apartament” me sipërfaqe 29.86 m², nr. pasurie ***, Z. K. ***, vol. ***, f.***, rr. “***.***”, ***, Tiranë. Kjo pasuri është fituar me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, me palë shitëse znj. ***.*** dhe z. ***.***, për vlerën 46.000 euro, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten znj. ***.***, me pjesë takuese 50% secili.

46. **Pasuria nr.3. Në D-Vett deklarohet:** “Garazh” me sipërfaqe 12.5 m², nr. pasurie ***, Z. K. ***, vol. ***, f. ***, rr. “***.***”, ***, Tiranë. Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, me palë shitëse znj. ***.*** dhe z. ***.***, për vlerën 24.000 euro, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten znj. ***.***, me pjesë takuese 50%.

²⁴ Sipas dokumentacionin të sjellë nga shoqëria “****” sh.p.k., rezulton se ndërtimi për objektin. me sip. 268.2 m², dy kate + papafingo ka përfunduar në korrik 2004.

²⁵ Shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë.

²⁶ Referuar edhe rekomandimit të ONM-së (f.6).

²⁷ Njësi ekonomike familjare me katër anëtarë.

²⁸ Në analizën paraprake financiare të kryer për SR N. Kosova nga Kolegji rezulton se janë përdorur tri metoda për përlogaritjen e shpenzimeve të jetesës: (i) në masën 66% për të ardhurat deri në 31.12.2002, dhe në vijim sipas të dhënave të ILDKPKI / INSTAT; (ii) në masën 66% të të ardhurave, për të ardhurat deri në 31.12.1999, dhe në vijim sipas të dhënave të ILDKPKI / INSTAT apo (iii) në masën 66% për të ardhurat deri në 31.12.2002, dhe në vijim sipas të dhënave të NJEF/CPI/Qark në vijim.

Burimi i krijimit për pasurinë nr. 2 dhe nr. 3, së bashku në vlerë totale 70.000 euro, janë deklaruar: të ardhurat nga shitja e apartamentit²⁹ me sip. 115.08 m², në adresën rr. “****.***”, pallatet “****”, Tiranë, shitur z. ****.***, në shumën 130.000 euro. Për blerjen e këtij apartamenti me sipërfaqe 115.08 m², deklarohen si burim të ardhurat e bashkëshortes znj.****.***, përfitur nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 102 m², me adresën Rr. ****, ****, Tiranë, në shumën 50.000 euro. Në cilësinë e personit të lidhur, por dhe si deklaruese për shkak të detyrës, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ****.*** deklaron se ka siguruar të ardhurat për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 102 m² nga (a) kredi bankare pranë *** Bank, në shumën 23.000 euro; (b) 9.000 euro nga kursimet familjare, për periudhën 2001-2005.

47. Për pasuritë 2 dhe 3, burimi i krijimit të tyre në vlerën totale prej 70.000 euro, është i njëjtë, ndaj dhe trajtimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive, në vijim, do të bëhet së bashku.
48. Në lidhje me burimin e deklaruar në vlerë totale prej 70.000 euro, për blerjen e dy pasurive, nga shqyrtimi i akteve, Komisioneri Publik konstaton se origjina e krijimit të këtyre pasurive rrjedh nga kontrata shitblerje të njëpasnjëshme si në vijim:
- (i) Me kontratë sipërmarrje nr. *** rep., datë ***.7.2005, znj.****.*** ka porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., apartament me sipërfaqe 100.9 m², me adresë Rr. ****, ****, Tiranë, për vlerën 32.288 euro;
 - (ii) Me kontratë shitje pasuri e paluajtshme me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2007, znj. ****.*** i ka shitur blerësit ****.***, apartament me sipërfaqe 102 m², me adresë Rr. ****, ****, Tiranë, për vlerën 50.000 euro;
 - (iii) Bashkëshortja e subjektit, znj. ****.***, ka blerë sipas kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2008, për shumën 43.370 euro, nga shoqëria “****” sh.p.k., apartamentin me sipërfaqe 115.08 m², ndodhur në adresën rr. “****.***”, pallatet “****” Tiranë³⁰.
 - (iv) Pas rivlerësimit të apartamentit³¹ me sipërfaqe 115.08 m², bashkëshortja e subjektit ia ka shitur këtë apartament z. ****, me kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2016, për shumën 130.000 euro.
49. Për secilin nga transaksionet e mësipërme, znj. ****.***, në cilësinë e personit që ka mbartur detyrimin për deklarim³², ka deklaruar pranë ILDKPKI-së interesat e saj private pasurore si vijon:

49.1 **Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës**, me nr. indeksi ****, dorëzuar në ILDKPKI, në datë ***.4.2006, bashkëshortja e subjektit, znj. ****.***, deklaron: “Apartament” me sipërfaqe 110 m², Komuna ****, ****, Tiranë. Vlera 32.000 euro, pjesa në zotërim 100%. **Burimi i krijimit:** (i) kredi bankare nga ****, në shumën 23.000 euro (ii) diferenca, nga të ardhurat e krijuara gjatë viteve.

49.2 **Në DV - 2007**, bashkëshortja e subjektit, znj. ****.***, ka deklaruar shitjen e apartamentit me sipërfaqe 110 m² në ****, Tiranë, për vlerën 50.000 euro, në pronësi të saj dhe ka shtuar pasurinë me blerjen e apartamentit me sipërfaqe prej 126.5 m² në rr. “****.***”, Tiranë, për shumën 48.070 euro, pjesa në zotërim 100%.

49.3 **Në DV - 2008**, bashkëshortja e subjektit, znj. ****.***, ka deklaruar shitjen e apartamentit me sipërfaqe prej 110 m² në ****, Tiranë, për vlerën 50.000 euro, në pronësi të saj

²⁹ Në pronësinë 100% të bashkëshortes znj.****.***.

³⁰ Porositur me Kontratë Porosie nr.*** rep. nr.*** kol., datë ***.05.2007 për vlerën 48.070 euro.

³¹ Apartamenti është rivlerësuar në shumën 18.5 milionë lekë, në bazë të aplikimit nr.***, datë ***.12.2011 në ZVRPP Tiranë.

³² Duke qenë se ka punuar pranë Drejtorisë së Tatimeve Tiranë nga data ***.04.2006, ka pasur detyrimin për deklarim bazuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, i ndryshuar.

dhe ka shtuar pasurinë me blerjen e apartamentit me sipërfaqe prej 126.5 m² në rr. “****.***”, Tiranë, për shumën 48.070 euro, pjesa në zotërim 100%.

50. Nga përmbajtja e akteve, sjellë nga ZVRPP Tiranë dhe DV ndër vite të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, rezulton se të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurive 2 dhe 3, aktualisht në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, kanë si origjinë apartamentin me sipërfaqe 110 m², Rr. ****, ****, Tiranë, e për këtë qëllim do të duhet të hetohet gjendja pasurore dhe financiare e bashkëshortes së subjektit në momentin e krijimit të pasurisë.

51. Nisur nga arsyetimi i vendimit (f. 22, 23), Komisioni, duke kualifikuar bashkëshorten si “*person të lidhur*”³³ me subjektin e rivlerësimit që mbart detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit,³⁴ të apartamentit në adresën Rr.****, ****, Tiranë, ka kryer veprime hetimore. Komisioni, në lidhje me saktësinë, mjaftueshmërinë e këtij deklarimi dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament me sip.110 m², Rr.****, ****, Tiranë, në vendimin e tij, ka analizuar dy zërat të deklaruar si burim krijimi për këtë aset.

51.1 Hua nga **** Bank, në shumën 23.000 euro. Nga dokumentacioni shkresor përcjellë Komisionit, nga **** Bank,³⁵ ka rezultuar se znj. ****.*** ka marrë kredi pranë **** Bank në shumën 23.000 euro, sipas kontratë kredie nr. **** rep., nr.,**** kol., me qëllim blerje apartamenti, disbursuar në llogarinë e saj në datë ****.11.2004. Në aktet e dosjes së kredisë bankare është e depozituar edhe deklarata noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë ****.9.2004, nënshkruar nga z. ****.*** dhe znj. ****.***.

51.2 Referuar përmbajtjes së deklaratës, huadhënësi z. ****.***, deklaroi se në maj 2004 i ka dhënë hua pa interes, në shumën 23.000 euro, znj. ****.*** për “*ndërtimin e një shtëpie*” në ****, Tiranë. Shuma do t’i kthehej huadhënësit brenda vitit 2004 (*nuk rezulton që Komisioni të ketë kualifikuar z.****.*** si person tjetër i lidhur, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016*). Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë, ka rezultuar se pas disbursimit të kredisë bankare nga **** Bank, shuma 22.615³⁶ euro është transferuar në datë ****.11.2004, në llogarinë e z.****.***, me përshkrimin “*transfer to the account of the lender*”³⁷.

51.3 Nga hetimi administrativ, Komisionit i ka rezultuar se kredia nga **** Bank është përdorur për shlyerjen e huas së marrë z.****.***. Ndërkohë, ndryshe nga sa më lart, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, bashkëshortja e subjektit znj. ****.***, ka deklaruar se apartamenti me sipërfaqe 110 m², Komuna ****, ****, Tiranë, është blerë me këtë kredi bankare.

51.4 Gjatë hetimit administrativ lidhur me mënyrën e likuidimit të këtij asemi (apartament me sipërfaqe prej 110 m²), për efekt të procesit të rivlerësimit, shoqëria “****” sh.p.k., bashkëlidhur shkresës së saj nr. **** prot., datë ****.8.2018, i ka paraqitur Komisionit dy mandate arkëtimi: (i) mandatin nr. ****, datë ****.7.2005, në shumën 20.000 euro dhe (ii) mandatin nr. ****, datë ****.1.2006, në shumën 12.000 euro.

51.5 Në vlerësim të rrethanave sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar se: (i) nuk përputhet me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe me deklarimin e bërë nga subjekti gjatë këtij hetimi, destinacioni i shpenzimit të kredisë 23.000 euro nga **** Bank për blerjen/porositjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., në vitin 2005, (ii) lidhur me momentin e shlyerjes së vlerës së apartamentit të shoqëria “****” sh.p.k., nga deklarimi në deklaratën e interesave përpara fillimit të detyrës së personit të lidhur, shuma 32.000 euro është likuiduar deri në fund

³³ Sipas nenit 3, pika 13, të ligjit nr. 84/2016.

³⁴ Bazuar në nenin 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë”.

³⁵ Me shkresën nr. ****, datë ****.1.2018.

³⁶ Nga shuma e disbursuar prej 23.000 euro, është transferuar te z. ****.*** shuma 22.615 euro.

³⁷ Në rubrikën kushte speciale të disbursimit specifikohet “*Transfer of the funds at the account of Mr. ****.*** (the lender)*”.

të vitit 2005, fakt që nuk përputhet me deklaratimet e palëve kontraktuese gjatë hetimit administrativ, ku subjekti dhe shoqëria e ndërtimit kanë deklaruar se në vitin 2005 u likuidua vetëm 20.000 euro dhe në ***.01.2006, shuma prej 12.000 euro.

51.6 Komisioni për çështjet e mësipërme i ka kaluar subjektit **barrën e provës**, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Në parashtrimet e datës 16.4.2019, subjekti ka pretenduar se: “... Banka *** ka miratuar kredinë në shumën 23.000 euro dhe kjo shumë pas disbursimit është kaluar në llogarinë e bashkëshortes në datën 22.11.2004. Në datën 23.11.2004 është bërë shlyerja e borxhit ndaj z.***.***, vërtetuar kjo me transfertën e shumës nga llogaria e bashkëshortes te llogaria e z. ***.*** në shumën 22.615 euro, sipas ekstraktit bankar dhe diferenca prej 385 euro është shlyer cash. Në pamundësi të ndërtimit të shtëpisë (kjo për shkak se nuk është bërë e mundur marrja e lejes së ndërtimit), shuma e mbetur në dispozicion prej 23.000 euro është përdorur për të porositur apartamentin sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë ***.7.2005, me adresë ***, ***, Tiranë. Veprimet e ndodhura gjatë vitit 2004 me z. ***.*** ishin veprime të ndërmjetme, zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik, pra në thelb destinacioni i kredisë së marrë u bë blerja e apartamentit nga shoqëria ‘***’ sh.p.k...”.

51.7 Lidhur me kohën e kryerjes së pagesave dhe mënyrën e likuidimit, subjekti në parashtrimet e së njëjtës datë, 16.4.2019, ka pretenduar se: “...në asnjë rast bashkëshortja nuk ka deklaruar se janë paguar 32.000 euro deri në fund të vitit 2005. Deklarimi i dhënë nga bashkëshortja ime i referohet deklaratimit periodik të vitit 2005, i cili është deklarimi përpara fillimit të detyrës së saj. Si e tillë, kjo deklaratë nuk jep gjendjen e pasurive dhe detyrimeve deri në datën 31.12.2005, por jep gjendjen e pasurive dhe detyrimeve deri në datën 3.4.2006. Në deklaratën e dorëzuar në datë 5.4.2006, në faqen ku deklarohen: ‘Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë’ kërkohet deklarimi i detyrimeve të tjera që mbeten ende pa u shlyer deri në datën e fillimit të detyrës prej zyrtarit. Në këtë deklaratë, datë 3.4.2006, nuk është deklaruar detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ‘***i’ sh.p.k., në shumën 12.000 euro, pasi nuk ishte detyrim ligjor deklarimi i kësaj shume për sa kohë kjo shumë nuk ekzistonte më si detyrim në datën 3.4.2006”.

51.8 Duke iu referuar këtyre rrethanave faktike dhe ligjore, bazuar dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij (f. 23, 24), ka arsyetuar: “...Referuar përcaktimeve ligjore në nenin 5/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, është parashikuar se deklarohet gjendja e pasurive dhe çdo angazhim apo të ardhura deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklaratimit. Pra, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka dhënë deklarinin duke pasur parasysh faktin se, deri në datën e dorëzimit të deklaratës, datë 3.4.2006, detyrimi ndaj shoqërisë “***” sh.p.k. ishte shlyer tërësisht³⁸...Lidhur me destinacionin e shpenzimit të kredisë prej 23.000 eurosh, për huan e marrë në vitin 2004, trupi gjykues çmon se shpjegimi i subjektit ka të bëjë me veprime të ndërmjetme - zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik/periudhë, nuk është bindës, pasi nuk ka ‘praktika të zëvendësimit të debitorit’ - pa miratimin paraprak të kreditorit... Në përfundim, Komisioni konkludon që jemi përpara një pasaktësie në deklarinin të personit të lidhur dhe për rrjedhojë edhe të subjektit të rivlerësimit, por që nuk e cenon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave”.

52. Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, në shpjegimin e subjektit të rivlerësimit dhe në vendimin e Komisionit, që bazohet në këto shpjegime, konstatohet se është e mangët logjika financiare. Ky konstatim vjen nisur nga fakti që, ndërkohë që pretendohet se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit i kishte të papërdorura fondet që mori hua pa interes nga z. ***.***, në maj të vitit 2004 (për shkak se sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit nuk u bë e mundur

³⁸ Mandate arkëtimi nga znj.***.***: nr. *** , datë ***.7.2005, në shumën 20.000 euro dhe nr. *** , datë ***.1.2006, në shumën 12.000 euro.

marrja e lejes së ndërtimit), në nëntor të vitit 2004, znj. ***.*** merr një kredi bankare (me interes) në shumën 23.000 euro, për të shlyer huan e marrë pa interes z. ***.***, fondet e së cilës i kishte gjendje të përdorura.

52.1 Lidhur me mënyrën e shlyerjes së kredisë bankare, referuar lëvizjeve të llogarisë së vënë në dispozicion Komisionit nga *** Bank, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.*** ka depozituar *cash* në *** Bank shumën 20.042 euro, në datë 28.5.2008, dhe po në të njëjtën datë është shlyer vlera e plotë e detyrimit të kredisë.

52.2 I pyetur nga ana e Komisionit lidhur me mënyrën e shpenzimit të shumës prej 220.000 euro, përfituar nga shitja e shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë, nga familja ***, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 14.8.2018, sqaron se 20.000 euro³⁹ prej kësaj shume kanë shkuar për shlyerjen e kredisë së marrë nga personi i lidhur pranë *** Bank.

52.3 **Komisioneri Publik** konstaton se lidhur me këtë “*shumë të dhuruar*” nga familja ***, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përdorur për mbylljen e kredisë pranë *** Bank, në vlerën 20.042 euro, nuk rezulton që të jetë hetuar nga Komisioni nëse është paguar tatimi në burim, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ndryshuar. Në rast se kjo pagesë vlerësohej që do të duhej të kryhej, atëherë rrjedhimisht do të ndikonte në analizën financiare lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë apartamentit me sipërfaqe 102 m², Rr. ***,***, Tiranë.

53. *Mbi kursimin në shumën 9.000 euro*, të deklaruar si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit, pranë shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 12.000 euro, në datë 19.1.2006, Komisionit i ka rezultuar se personi i lidhur ka pasur mundësi financiare të kursejë shumën e deklaruar, për pagesën e këstit të dytë të asetit. Referuar arsyetimit të vendimit (f. 23, 24), Komisioni këtë përfundim e ka arritur bazuar në informacionin e dërguar nga DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2018. Nga përmbajtja e dokumentacionit tatimor, pasqyruar në këtë korrespondencë zyrtare, rezulton se nga aktiviteti privat (konsulencë financiare), bashkëshortja e subjektit ka realizuar fitim neto 655.000 lekë në vitin 2004, dhe 1.165.957 lekë në vitin 2005. Në vijim, Komisioni arsyeton se shuma totale prej 1.820.957 lekë ose ekuivalenca prej 14.683 euro, është një burim i mjaftueshëm për të justifikuar të ardhura të ligjshme në shumën prej 9.000 euro, përdorur për shlyerjen e këstit e dytë të apartamentit⁴⁰.

54. Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, mangësitë në hetimin e Komisionit në përcaktimin e drejtë të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me kontrollin dhe ligjshmërinë për burimet dhe të ardhurat që shërbyen për krijimin e pasurisë, apartament me sipërfaqe 102 m², ndodhur në adresën Rr. ***,***, Tiranë, qëndrojnë në elementet si në vijim:

54.1 *Mbi justifikimin e të ardhurave të ligjshme për kursimin e deklaruar në shumën 9.000 euro*. Komisioneri Publik konstaton se Komisioni në hetimin lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për kursimin e shumës prej 9.000 euro, ka analizuar të gjitha të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, që janë realizuar gjatë gjithë vitit 2004. Por, ndërkohë, nënvizojmë se këto të ardhura janë llogaritur një herë më parë, nga Komisioni kur është vlerësuar burimi i të ardhurave që ka shërbyer për mbulimin e kostos së ndërtimit të shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330 m²), ndodhur në ***, Tiranë.

³⁹ Subjekti në përgjigjet e datës 14.8.2018 ka referuar kontratën e kaparit nr. *** rep. nr. *** kol., datë ***.5.2008, e nënshkruar nga ***.***, në cilësinë e kaparpaguesit, dhe ***.*** dhe ***.***, në cilësinë e kaparmarrësve. Objekt i kësaj kontrate është dhënia e një shume në formë kapari, prej 20.000 euro.

⁴⁰ Sipas mandatit nr. ***, datë ***.01.2006, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., shuma e paguar është 12.000 euro. Sipas shpjegimeve të subjektit nga kjo shumë, 3.000 euro janë mbuluar me pjesën e mbetur të kredisë prej 23.000 euro dhe pjesa tjetër prej 9.000 euro është mbuluar me kursime familjare.

54.2 Gjithashtu, **Komisioneri Publik vlerëson** se duhet kryer një analizë e plotë financiare mbi të ardhurat, shpenzimet dhe investimet⁴¹ e kryera nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2005. Kjo, nisur nga fakti që Komisioni nuk ka kryer një analizë të plotë financiare për këtë element, por është mjaftuar vetëm me të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e subjektit si person fizik, në vitet 2004-2005. Ndërkohë që në vlerësimin analitik duhet konsideruar dhe shpjegimi i vetë subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e tij të datës 19.10.2018, ku shprehet se: “... të gjitha mjetet monetare të realizuara prej bashkëshortes deri në momentin kur mori hua shumën 23.000 euro nga ***.*** (maj 2005) ishin vënë në dispozicion të ndërtimit të shtëpisë private”.

54.3 **Mbi pagimin e detyrimeve tatimore.** Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Tiranë, rezulton se znj.***.*** ka lidhur me z. ***.*** një kontratë shitje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2007, për një apartament me sipërfaqe 102 m², ndodhur në adresën Rr. ***, ***, Tiranë, për një vlerë prej 50.000 euro. Në nenin 3 të kësaj kontrate përcaktohen modalitetet e pagesës në dy këste: (i) kësti i parë prej 20.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe (ii) kësti i dytë prej 30.000 euro do të paguhej deri në 30 tetor 2007.

54.4 Si dokument provues për shlyerjen e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e këtij aseti⁴², subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën e DRT Tiranë nr. *** prot., datë ***.8.2018. Referuar përmbajtjes së kësaj shkrese, rezulton se znj. ***.*** ka deklaruar në “*Deklaratën e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat*” në zërin: “*Pagesat për ndërtimin, instalimin, mobilimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to dhe për kalimin e së drejtës së pronësisë për periudhën dhjetor 2016, vlerën 378.000 lekë, të cilën e ka paguar në 24 janar 2017*”.

54.5 Marrë në konsideratë rrethanat e mësipërme dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi **barrën e provës** subjektit për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën lidhur me: (i) dokumentin ligjor provues lidhur me deklarin e subjektit në D-Vett., për sa i përket burimit të të ardhurave të shumës 30.000 euro, realizuar nga shitja e apartamentit të z. ***.*** (deklaruar nga personi i lidhur në *deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës*); (ii) paqartësitë në lidhje me pagesën e tatimit në vitin 2017 (10 vite me vonesë), në shumën prej 378.000 lekë për transaksionin e kalimit të të drejtave reale, nga znj.***.*** të z.***.*** në 2007, pasi nga subjekti nuk ishin depozituar dokumente provuese sa i takonte: (a) kontratës dhe dokumenteve që ishin vlerësuar nga administrata tatimore për përllogaritjen e tatimit; (b) metodologjisë së zbatuar nga administrata tatimore për të përcaktuar se detyrimi tatimor ishte në vlerën 378.000 lekë; (c) kohës kur kishte lindur detyrimi; (d) penalteteve të mundshme ose kufizimeve për pagesa të vonuara etj.

54.6 **Në parashtrimet e datës 16.4.2019**, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: “... z. ***.*** për këtë apartament kishte shlyer shumën 50.000 euro ndaj znj. ***.***”. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2019, ku z. ***.*** konfirmon pagesën e plotë të shumës prej 50.000 eurosh znj. ***.***, si dhe faktin që nuk kishte pasur asnjëherë një marrëdhënie pagese me shoqërinë “****” sh.p.k. Rezultoi se Komisioni në vendimin e tij i referohet edhe përmbajtjes së kësaj deklarate noteriale në lidhje me rrethanat e pretenduara në të, përkundër jurisprudencës së Kolegjit në raste të ngjashme⁴³.

⁴¹ Nga aktet në dosje na rezultoi se bashkëshortja e subjektit në datë ***.10.2005, me faturën tatimore nr. ***, ka blerë një automjet nga “***.***.***”, për shumën 1.200.000 lekë. Gjithashtu nga dhjetori i vitit 2004 e në vazhdim, bashkëshortja e subjektit ka pasur shpenzime kredie, me këtë rreth 233 euro/muaj.

⁴² Rezultoi se apartamenti është blerë për vlerën 32.000 euro dhe është shitur në vlerën 50.000 euro.

⁴³ Shihni vendimin e Kolegjit (JR) nr. 10, datë 19.11.2018, për subjektin e rivlerësimit ***.***

54.7 Lidhur me paqartësitë për procedurat e ndjekura për pagesën e tatimit me 10 vjet vonesë, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij të datës 16.9.2019, shprehet se: “...*Tatimi në burim i paguar në datën 14.1.2017, i referohet kontratës së shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2007, me çmimin 50.000 euro, si dhe kontratës së porositjes së këtij apartamenti të shoqëria “***” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë ***.7.2005, në shumën 32.000 euro. Tatimi i paguar në shumën 378.000 lekë i referohet pikërisht taksimit me normën e tatimit në burim prej 15 %, në vitin 2017, mbi diferencën e çmimit të shitjes me çmimin e blerjes [(50.000 euro – 32.000 euro) x 15% x 140 lekë/euro = 378.000 lekë]. Meqenëse ky tatim i papaguar u konstatua gjatë plotësimit të deklaratës Vetting 2017 dhe konkretisht në datën 23.1.2017, u procedua me deklarin dhe pagesën e tij. E vetmja mundësi për të deklaruar këtë shumë ishte deklarimi në muajin paraardhës të konstatimit, pra meqenëse u konstatua në janar 2017 u përdor deklarata e muajit dhjetor 2016 si mundësi deklarimi e kësaj shume. Duke qenë se u konstatua në janar 2017, deklarata e muajit janar nuk ishte shfaqur akoma në sistemin tatimor, dhe për këtë arsye u deklarua si e ardhur neto për muajin dhjetor 2016. Shkresa e administratës tatimore nuk tregon gabimisht periudhën dhjetor 2016, kjo shkresë përshkruan saktësisht atë që bashkëshortja, znj. ***.***, ka deklaruar në 23.1.2017, në deklaratën tatimore të tatimit në burim për periudhën dhjetor 2016... Koha për të cilën ka lindur ky detyrim është muaji prill 2007, por duke qenë se për atë periudhë në sistemin tatimor nuk ekziston deklarata e tatimit në burim, është proceduar me deklarin dhe pagesën e këtij detyrimi në periudhën aktuale, pra për muajin dhjetor 2016... Në këtë rast kemi të bëjmë me vetëdeklarim nga bashkëshortja, znj. ***.***, dhe nuk kemi të bëjmë me vlerësim nga administrata tatimore, pra administrata tatimore nuk ka kryer asnjë proces vlerësimi. Për rrjedhojë nuk ka as edhe një metodologji të përdorur nga kjo administratë në lidhje me llogaritjet e mësipërme. Administrata tatimore nuk mund të bëjë vlerësim për periudhën tatimore prill 2007 për detyrime tatimore (përfshirë kamatëvonesat edhe penalitetet), pasi bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 73, pika 1, është parashikuar se: “1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 vjetëve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”.*

54.8 Duke iu referuar këtyre shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij (f. 27) ka arritur në përfundimin se: “... lidhur me pagesën e tatimit me vonesë, bazuar në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, çmon se pagesa e këtij tatimi, përpara dorëzimit të deklaratës “Vetting”, përmbush kriterin ligjor të burimit të ligjshëm të konfirmuar nga deklarata noteriale e blerësit, si dhe të të ardhurës neto, pasi për shumën në fjalë është shlyer detyrimi tatimor.”

54.9 **Komisioneri Publik**, marrë në konsideratë së bashku rrethanat e faktit dhe ligjore që lidhen me: (i) tatimi mbi të ardhurat është paguar me 10 vite vonesë; (ii) vetëm disa ditë para dorëzimit të D-Vett.; (iii) përshkrimi i pagesës së tatimit nuk lidhet qartësisht me transaksionin për të cilin paguhet detyrimi; duke iu referuar dhe rekomandimit të ONM-së, datë 24.7.2019, vlerëson se do të ishte i nevojshëm interpretimi/orientimi i Kolegjit për të arritur në përfundimin nëse të ardhurat për të cilat pagesa e detyrimeve tatimore kryhet me vonesë, gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, do të duhet të konsiderohen ose jo si të ardhura të ligjshme, në interpretim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

55. **Pasuria nr. 4. Në D-Vett deklarohet:** (i) *Apartament me sipërfaqe totale 205.33 m² (158 m² sipërfaqe e brendshme dhe 47 m² sipërfaqe verandë), me adresë fshati “***”, Durrës, fituar me: (i) kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2012, dhe (ii) kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.8.2015, me vlerë 82.132 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten me pjesë takuese 50% secili. (ii) *Trualli mbi të cilin ndodhet apartamenti me sip. 521.8 m². Pagesa për procesin e legalizimit në shumën 984.199 lekë, me kontratë**

sipërmarrje⁴⁴ nr. *** rep. nr.*** kol., datë ***.6.2012 dhe kontratë shitblerje nr*** rep. nr. *** kol., dt. ***.8.2015., në bashkëpronësi me bashkëshorten me pjesë takuese 50% secili.

Burim krijimi: (i) 35.000 euro të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 48.27 m², në Shëngjin, Lezhë, në pronësi 100% të subjektit. Ap. me sip.48.27 m², në Shëngjin, Lezhë, është blerë në shumën 2 milionë lekë, përfituar nga vendimi i pjesëtimit të pasurisë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë ***.6.2006; (ii) 30.000 euro, kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, krijuar para martesë (ii.1) të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, siguruar nga shitja në shumën 220.000 euro e shtëpisë private 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m².

55.1 Në DV-2012 deklarohet: Shtuar apartament me sip. 205.33 m² (158 m² sipërfaqe e brendshme dhe 47 m² sipërfaqe ballkoni), Komuna ***, Durrës, fituar me kontratë nr. *** rep. nr. *** kol., datë ***.6.2012, për vlerën 82.132 euro. *Pjesa takuese: 50%. Lidhur me burimin* ka deklaruar: likuidim i pjesshëm në shumën 40.000 euro, duke pakësuar gjendje *cash*.

55.2 Në DV-2013 deklarohet: lidhur *me burimin e apartamentit:* likuidim i pjesshëm në shumën 30.000 euro, duke pakësuar gjendje *cash*. Për burimin e krijimit të truallit deklarohet: pakësuar gjendja *cash*, e krijuar gjatë viteve të mëparshme.

55.3 Gjatë hetimit administrativ, lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për mbulimin e diferencës së çmimit në vlerën prej 17.132 euro, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 14.8.2018 ka deklaruar si burim: (i) 5.000 euro të ardhura nga kursimet familjare të vitit 2012⁴⁵; (ii) 8.010 euro të ardhurat nga kontrata qiraja për vitit 2014⁴⁶ (iii) të ardhura familjare të vitit 2014 në shumën 4.122 euro. Në vijim do të trajtojmë secilin prej këtyre zërave për krijimin e pasurisë nr. 4.

55.4 Po ashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *shpenzime mobilimi* për pasurinë 4, në shumën 950.000 lekë (për periudhën 2012-2014).

56. Në lidhje me burimin e deklaruar të të ardhurave të ligjshme në vlerën prej 35.000 euro, nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Tiranë⁴⁷ dhe ZVRPP Lezhë⁴⁸, rezulton se janë kryer disa transaksione si më poshtë:

- i. Me kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2003, subjekti i rivlerësimit z. Kastriot Selita dhe ish-bashkëshortja e tij, znj.***.*** (Selita) kanë blerë apartamentin me sipërfaqe prej 73 m² me adresë rr. “***.***”, Tiranë, për vlerën prej 2.000.000 lekë.
- ii. Pas zgjidhjes së martesës me marrëveshje, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përfituar shumën monetare prej 2.900.000 lekë, nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë ***.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zgjidhjen e martesës dhe pjesëtimin e pasurisë. Referuar dispozitivit të vendimit në fjalë, ish-bashkëshortët Selita kanë pjesëtuar pasurinë e krijuar gjatë martesës sipas aktmarrëveshjes datë ***.6.2006. Sipas kësaj aktmarrëveshje, është rënë dakord që pronësia e apartamentit dhe orenditë do t’i kalojnë znj. ***.***, ndërsa kjo e fundit detyrohej t’i paguante subjektit të rivlerësimit z. Kastriot Selita shumën prej 2.900.000 lekë. Në lidhje me sqarimin e momentit dhe mënyrës së përfitimit të vlerës prej 2.900.000 lekë nga subjekti i rivlerësimit, shtetasja ***.***,⁴⁹ në cilësinë e avokates së subjektit të rivlerësimit në kohën e kryerjes së procedurave për

⁴⁴ Në kontratën e sipërmarrjes është parashikuar mënyra e pagesës: (i) shuma 40.000 euro është paguar nga porositi në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe (ii) pagesa e fundit do të bëhet në muajin maj 2013.

⁴⁵ Në DV-2012 subjekti ka deklaruar shtuar *cash* 5.000 euro, gjithashtu ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* në DPV-2013 për shumën 30.000 euro.

⁴⁶ në DV-2014 subjekti ka deklaruar të ardhura neto nga qiraja për apartamentin 126 m² në Tiranë dhe për apartamentin në komunën ***, me vlerë totale 8.010 euro.

⁴⁷Shkresa me nr.*** prot., dt. ***.2.2018.

⁴⁸Shkresa me nr. *** prot., dt. ***.9.2018.

⁴⁹ Me përgjigjen me email, e datës ***.1.2019.

zgjdhjen e martesës, ka parashtruar se: “... ka marrë fizikisht shumën 2.900.000 lekë nga znj. ***, **, e cila e ka tërhequr shumën nga *** Bank dhe, më pas, avokatja ia ka kishte dorëzuar subjektit të rivlerësimit”. Me shkresën nr.*** prot., datë ***.1.2019, të *** Bank, konfirmohet derdhja cash e shumës 2.900.000 lekë, në datë 13.6.2006 nga znj. ***, ** dhe tërheqja e po kësaj shume në datë 19.6.2006.

iii. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep. nr. *** kol., datë ***.1.2010, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sipërfaqe 48.27 m², në Shëngjin, Lezhë, për çmimin 2.000.000 lekë⁵⁰.

iv. Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.5.2011, subjekti i rivlerësimit i ka shitur apartamentin në Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 48.27m², z. ***.**, për një vlerë prej 38.000 euro. Në çmimin e shitjes prej 38.000 euro janë përfshirë dhe shpenzimet e mobilimit në shumën 3.000 euro. Rezulton se është kryer transfera bankare pranë *** Bank, në datë ***.5.2011, në shumën 29.900 euro, nga z. ***.**, me përfitues z. Kastriot Selita, me përshkrimin e veprimit: “Kalim fondi për blerje shtëpie”.

56.1 Për mënyrën e përfitimit të diferencës së çmimit në shumën prej 8.100 euro, cash, nga shitja e apartamentit në Shëngjin, Lezhë, Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në D-Vett., për shlyerjen e shumës cash prej 8.100 euro, nuk mbështetet në dokumentacion provues. Lidhur me këtë fakt i ka kaluar subjektit **barrën e provës** për të dhënë argumentet përkatëse në lidhje me konstatimet e bëra, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

56.2 Në parashtrimet e tij të datës 16.4.2019, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: “...në lidhje me pagesën në cash të shumës 8.100 euro si pjesë përbërëse e çmimit të apartamentit në Shëngjin të Lezhës, përveç kontratës së shitjes të cilën jua kemi dërguar më parë, ju vëmë në dispozicion edhe deklaratën noteriale Repertori Nr.***, Koleksioni Nr.***, datë ***.4.2019, të blerësit z. ***, **, sipas së cilës vërtetohet kjo pagesë cash”.

56.3 **Komisioneri Publik**, referuar jurisprudencës së Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjerë, vlerëson se kjo deklaratë noteriale daton pas dorëzimit të D-Vett., është administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit, mbeten thjesht në nivel deklarativ, nuk mund të konfirmojë e vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera provueshmërinë që faktet e deklaruara në të kanë ndodhur realisht.

57. Lidhur me transaksionet e kryera më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:

57.1 Në DV-2003 deklarohet: Apartament, ndodhur në rr. “****.***”, Tiranë, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol, datë ***.12.2003, për vlerën 2.000.000. *Burimi i krijimit:* Kursime familjare. Pjesa takuese 50% me ish-bashkëshorten.

57.2 Në DV-2006 deklarohet: Pakësim i pasurisë së paluajtshme pasi e drejta e pronësisë i kalon ish-bashkëshortes, ***.**, sipas vendimit nr. ***, datë ***.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Subjekti ka marrë si shpërblim shumën 2.900.000 lekë gjendje në shtëpi, ku pjesa takuese është 100%.

57.3 Në DV-2008 deklarohet: Prenotim ap. 1+1, sipërfaqe 68 m² në Shëngjin, Lezhë, paguar kësti i parë në vlerën 1.2 milionë lekë, pa deklaruar burimin.

57.4 Në DV-2009 deklarohet: Pagesë për vlerën e mbetur të apartamentit në Lezhë, në shumën 800.000 lekë, si pakësim i gjendjes cash. Lidhur me burimin e 1.2 milionë në 2008, gjithashtu deklaroi pakësimin e gjendjes cash.

⁵⁰Shoqëria “****” sh.p.k. konfirmon derdhjet cash në llogari të shoqërisë pranë ***, respektivisht: 1) Shuma 10.000 euro, konvertuar në 1.200.000 lekë, paguar në datë ***.9.2008, me përshkrimin: *Likuidim pjesor i apartamentit (1+1) Shëngjin;* 2) Shuma 6.000 euro, konvertuar në 780.000 lekë, paguar në datë 26.3.2009, me përshkrimin: “*Likuidim kësti apartamenti (likuidim total)*”.

57.5 Në DV-2011 subjekti deklaron: Shitje apartamenti 1+1, me sip. 68 m² në Shëngjin, Lezhë, në muajin maj të vitit 2011, në shumën 38.000 euro, paguar tatim në burim në shumën 289.265 lekë. Pjesa takuese 100%.

57.6 Nga verifikimi i akteve, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2014, një pjesë e të ardhurave të përdorura për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 205.33 m² dhe truallit funksional, Komuna ***, Durrës, aktualisht në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, kanë si origjinë fillestare: (i) gjendjen pasurore dhe financiare të subjektit dhe ish-bashkëshortes, në momentin e krijimit të pasurisë bashkëshortore, apartament me sipërfaqe 73 m² në rr. “****.***”, Tiranë; (ii) gjendja pasurore dhe financiare e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj, në momentin e krijimit të asetit të pasurisë, shtëpi banimi (268.2 m²) dhe truall (330m²), ndodhur në ***, Tiranë, duke qenë se 30.000 euro janë deklaruar si dhuratë nga prindërit e bashkëshortes gjatë shkëputjes nga trunjo familjar në 2010.

57.7 Lidhur me pasurinë bashkëshortore me ish-bashkëshorten, znj. ***,***, nga analiza e kryer, Komisionit i ka rezultuar se ish-bashkëshortët Selita, për blerjen e apartamentit në rr. “****.***”, në vlerën 2.000.000 lekë, në datë 6.12.2003, nuk kishin mundësi financiare për blerjen e tij për një vlerë prej 757.479 lekë. Për rrjedhojë, subjektit i kaloi **barrën e provës**, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë shpjegime ose për të provuar të kundërtën. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “... *Sqarimi im bëhet vetëm për 50% të shumës, pasi kjo është edhe pjesa ime kontributive në këtë pasuri*”.

57.8 Në lidhje me kontributin e ish-bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit të marrë informacione nga ISSH-ja për të bërë llogaritjet e sakta për kontributin e saj prej 50%, pasi, bazuar në nenin 32/2, të ligjit 84/2016, ai është në pamundësi objektive për t’i siguruar këto informacione. Lidhur me këtë verifikim, Komisioni ka hetuar pranë ISSH-së, Drejtoria Rajonale Durrës⁵¹ dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës⁵², institucione që kanë përcjellë informacion në lidhje me të ardhurat e përfituara nga pagat e ish-bashkëshortes, për periudhën 2002-2005.

57.9 Pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në analizën përfundimtare të përfshirë në vendim (f. 36), Komisioni konkludon se: “...*kjo mangësi e burimeve financiare, për një total në shumën prej 225.245 lekësh, duke vlerësuar se ajo duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, nuk është e mjaftueshme në vetvete që të passjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016*”.

57.10 Lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave në shumën prej 2.9 milionë lekë⁵³, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e datës 16.4.2019 ka pretenduar se: “... *Sqarimi im bëhet vetëm për 50% të shumës së pjesëtuar, pasi kjo është edhe pjesa ime kontributive në këtë pasuri... Kontributi im në pasurinë e përbashkët ka qenë në masën 50 %, pasi kjo pasuri ishte krijuar në vitin 2003 dhe se kontributi prej 50 % i ish-bashkëshortes nuk ka pasur asnjë lloj ndikimi në pasurinë që zotëron, pasi i ka kaluar ish-bashkëshortes pas pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, sipas vendimit të pjesëtimit nr.***, akti i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë ***.6.2006*”.

57.11 Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, në një vlerë prej 2.900.000 lekë dhe mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes, znj. ***,***, Komisioni ka arsyetuar se: “... *Pozita e subjektit, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, është vetëm ajo e një pale në një transaksion që shkaktohet si rrjedhojë e përmbushjes së detyrimit, që rrjedh nga një*

⁵¹ Shkresa ISSH Durrës nr. *** prot., datë ***.1.2019.

⁵² Shkresa DRT Durrës nr.*** prot., datë ***.1.2019.

⁵³ Përfutuar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë ***.6.2006.

vendim gjyqësor, i cili është marrë pas divorcit të palëve ndërgjyqëse, që ushtrojnë të drejtat dhe liritë civile të parashikuara në Kodin Familjes, në Kodin Civil, nën kontrollin dhe miratimin e gjykatës dhe ekzekutimit përmes shërbimit përmbarimor”. Në çmuarjen ligjore të shumës 2.900.000 lekë duhet të mbahen në konsideratë faktet e provuara gjatë hetimit se kjo shumë është një vlerë që nuk ka qenë gjendje në sistemin bankar apo dhe e deklaruar gjatë deklarimeve periodike para divorcit, por ka qenë shumë e hyrë jashtë pasurisë bashkëshortore, si dhe në periudhën që është miratuar aktmarrëveshja e formalizuar me vendim gjyqësor, palët nuk kishin më statusin e bashkëshortëve. Në vlerësimin e rrethanave, trupi gjykues çmon se raporti mes palëve ndërgjyqëse nuk përbën marrëdhënie të posaçme interesi, sipas ligjit nr. 84/2016, ku palët nuk ndërvaren nga njëri-tjetri në ushtrimin e së drejtës së pjesëtimit, pasi çdo qytetar ka të drejtë (legjitimohet) që të realizojë të drejtat pasurore nëpërmjet gjykatës, pavarësisht dëshirës apo interesit të palës kundërshtare...Nën këto argumente, trupi gjykues çmon se nuk ka rrethana për të cilat ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur... Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti nuk ka qenë në një marrëdhënie huamarrje apo përfitimi të ndonjë dhurimi nga një person i tretë, ai nuk mbart detyrimin që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të marra nga të tretët...Se për përjashtimin e çdo dyshimi, për këtë burim kërkoi thirrjen e ish-bashkëshortes së subjektit për të dëshmuar për burimin e ligjshëm, e cila, me gjithë marrjen dijeni duke nënshkruar njoftimin, nuk u paraqit; (ii) se subjekti ka deklaruar dhe ka dëshmuar pamundësinë e tij për të provuar burimin e krijimit të shumës së blerjes së pjesës së pasurisë në bashkëpronësi, për shkak të cenimit të privatësisë së ish-bashkëshortes, bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, çmon se nuk ka rrethana që të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, për sa kohë nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pamundësia ligjore dhe objektive e subjektit rezulton në nivel provueshmërie” (f. 36-37 e vendimit).

58. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, datë 24 korrik 2019, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për sa i takon të ardhurave që subjekti i rivlerësimit pretendon se janë krijuar duke pasur burim të ligjshëm pjesëtimit e sendit të paluajtshëm si pasojë e zgjidhjes së martesës, lidhen si me interpretimin ligjor të detyrimit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret specifik (pasuri bashkëshortore në pjesë ideale), ashtu dhe me administrimin e rrethanave të faktit (mundësisë financiare).

58.1 Është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit, në momentin e përfitimit të shumës prej 2.900.000 lekë ka zgjidhur martesën me ish-bashkëshorten e tij, por në **vlerësimin e Komisionerit Publik**, kjo pasuri (likuiditet) e ka origjinën nga një pasuri në bashkëpronësi bashkëshortore ligjore, në pjesë ideale, ligjshmëria e së cilës për t'u provuar mbetet detyrim i subjektit të rivlerësimit. I njëjti interpretim ligjor vlen dhe për hetimin e burimit të krijimit të të ardhurave në vlerën prej 2.000.000 lekë, në vitin 2003, që shërbyen për blerjen e apartamentit në rr. “***.***”. Është vetë subjekti, që në deklarin e tij të parë në vitin 2004 si burim për krijimin e pasurisë ka deklaruar kursimet familjare, pra të tizat dhe bashkëshortes së tij, në një regjim bashkëpronësie ligjore, në pjesë ideale. Në rrethanat kur mund të rezultojnë eventualisht nga kryerja e analizës financiare, një pamundësi ish-bashkëshortëve Selita për të krijuar të ardhura të ligjshme në vitin 2003, për blerjen e këtij apartamenti, nuk mund të hamendësohet se kjo pamundësi i takon ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, pa u hetuar ose administruar prova, që provojnë të kundërtën e detyrimit të justifikimit të burimeve të ligjshme për vënien e pasurisë.

59. Lidhur me shumën 30.000 euro, deklaruar si një nga zërat për krijimin e pasurisë 4, është deklaruar si në vijim:

59.1 **Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës**, me nr. indeksi ***, dorëzuar në ILDKPKI në datë 5.4.2006, nga bashkëshortja e subjektit znj. ***.*** deklarohet:

(i) tokë 330 m² mbi të cilën ndodhet shtëpia 268.2 m², komuna ***,***. Vlera 660.000 lekë, pjesa takuese 25%. **Burimi i krijimit** të pasurisë nuk specifikohet.

59.2 Në DV - 2008, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaron: (i) pakësimin e pasurisë, shitur shtëpi private me 2 kate + papafingo 268.2 m², për shumën 220.000 euro dhe paguar tatimi në burim në shumën 15.635 euro. (Nga të ardhurat nga shitja e shtëpisë së lartpërmendur janë blerë dy apartamente banimi përkatësisht me sipërfaqe 106 m² me vlerë 62.000 euro dhe 101 m² me vlerë 58.000 euro, ndodhur të dy në adresën rr. “***.***”, pallatet “***”, Tiranë. Apartamenti me sipërfaqe 106 m² ka kaluar në pronësi të znj. ***.*** dhe apartamenti me sipërfaqe 101 m² ka kaluar në pronësinë e vëllait të saj, z. ***.***); (ii) gjendje cash nga të ardhurat nga shitja e shtëpisë, në shumën 60.000 euro me pjesën e saj takuese 25%; (iii) shlyer totalisht kredia e marrë në *** Bank, në vlerë totale 21.798 euro, në datë ***.5.2008.

59.3 Në DV - 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaron: (ii) gjendje cash nga kursimet vjetore familjare, në shumën 6.000 euro, me pjesën e saj takuese 50%.

59.4 Në DV-2010, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, deklaron: nga shuma totale e kursimeve cash e deklaruar në DV-2008 në shumën 60.000 euro dhe në DV-2009 në shumën 6.000 euro, shuma totale e gjendjes cash që unë zotëroj është 30.000 euro. Kjo gjendje është krijuar nga shitja e asetëve familjare të deklaruar në deklaratimet e mëparshme dhe kursimet e vitit 2009.

59.5 Nga dokumentet e administruar në dosjen e Komisionit dhe shkresat e përcjella nga ZQRPP, konstatohet se *de jure* pronar i vetëm i pasurisë shtëpi private me sipërfaqe 268.2 m² është babai i subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, ndërkohë referuar deklaratave të interesave periodike private, pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit përcaktohet të jetë 25%.

59.6 I pyetur nga Komisioni mbi identifikimin e pjesëve takuese në shumën që i përket çmimit të shitjes së kësaj shtëpie, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në parashtrimet e tij, datë 19.10.2018 se: “... në lidhje me shtëpinë e banimit në Komunën ***, ***, në pronësi të përbashkët familjare të bashkëshortes në korrik 2008, pjesa ideale (pasi nuk kanë qenë të paracaktuara pjesët në këtë bashkëpronësi) e bashkëshortes është 25%, kjo pasi familja e saj në vitin 2008 përbëhej nga 4 persona (***.***, babai ***.***, nëna ***.*** dhe vëllai ***.***)”.

59.7 Nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe ato të personit të lidhur (bashkëshortja) në deklaratat vjetore të interesave private, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32. pika 5. të ligjit nr. 84/2016, nga shpjegimet e datës 14.8.2018, rezulton se nga shuma 220.000 euro, bashkëshortja e subjektit deklaron se **ka përfituar shumat si vijon: (i)** 20.000 euro, për shlyerjen e kredisë së znj. ***.*** te *** Bank, **(ii)** 61.758 euro ka blerë apartamentin me sipërfaqe 94.6 m² në adresën rr. “***.***”, pallatet “***” dhe **(iii)** 30.000 euro dhënë cash pas ndarjes nga familja. Rezulton se në total nga shitja e asetit, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar shumën prej 111.758 euro, vlerë që i korrespondon rreth 55% të të ardhurave të përfituara nga shitja e shtëpi private me sip. 268.2 m².⁵⁴, ndërkohë është deklaruar nga vetë subjekti dhe bashkëshortja e tij, si pjesë në bashkëpronësi *de facto* të bashkëshortes vetëm 25%.

59.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit **barrën e provës** bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, për të provuar faktin e dorëzimit të shumës 30.000 euro.

⁵⁴ 204.365 euro, shuma neto e përfituar pas pagesës së tatimit në vlerë 1.902.280 lekë.

59.9 Për të provuar këtë fakt, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit deklaratën noteriale nr. *** rep. nr. *** kol., datë ***.4.2019, të babait të bashkëshortes, z.***.***⁵⁵.

59.10 **Komisioneri Publik**, referuar jurisprudencës së Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjera, vlerëson se kjo deklaratë noteriale daton pas dorëzimit të D-Vett., është administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si e tillë, ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit, mbeten thjesht në nivel deklarativ, nuk mund të konfirmojë e vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në të kanë ndodhur realisht.

59.11 Lidhur me pagesën e tatimit për këtë shumë (30.000), deklaruar si e dhuruar bashkëshortes nga familja e saj, rezulton se Komisioni ka hetuar nëse është paguar ose jo tatimi për këtë shumë, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime. Në parashtrimet e datës 16.4.2019, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se kjo shumë është përfituar nga bashkëshortja pas ndarjes nga trangu familjar i znj. ***.***.

59.12 Lidhur me vlerësimin për pagesën e tatimit të shumës së përfituar si dhuratë, Komisioni i është drejtuar edhe dy institucioneve për të marrë mendim dhe interpretim juridik, lidhur me trajtimin e të ardhurave të dhuruara individëve. Në përgjigjet e tyre,⁵⁶ këto institucione konstatojnë se individ i përfitues nga dhurimi i shumave monetare nuk i nënshtrohet parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat”, të ndryshuar, pasi një e ardhur e tatuar në burim nuk i nënshtrohet tatimit për herë të dytë.

60. Komisioneri Publik vlerëson se Komisionit i janë dhënë nga Kushtetuta dhe ligji të gjitha kompetencat e nevojshme për të interpretuar ai vetë legjislacionin në fuqi. Po ashtu, jurisprudenca e Kolegjit në raste të ngjashme, bazuar në parashikimet ligjore, shërben për orientimin e praktikave që ndjekin institucionet e rivlerësimit gjatë kryerjes së procesit. Komisioneri Publik çmon se referimi në interpretime të institucioneve, të cilave ligji nuk u njeh asnjë rol në procesin e rivlerësimit dhe përfshirja e këtyre interpretimeve në vendimin e Komisionit është i pavend.

60.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, datë 24 korrik 2019, mungesa e një interpretimi shterues dhe origjinar nga ana e Komisionit të dispozitave të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave në vlerën prej 30.000 euro, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, gjatë kryerjes së hetimit administrativ nga ana e Komisionit, e bën të mangët atë.

61. Pasuria 5. Në D-Vett deklarohe: “Autoveturë”, marka “Daimler Chrysler”, tipi (D) 211, me targë ***, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2009. *Vlera: 11.000 euro.*

61.1 *Në DV-Vett deklarohe si burim i krijimit:* (i) 900.000 lekë, “të ardhura nga vendimi i pjesëtimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. *** vendimi, datë ***.6.2006; (ii) 4.000 euro dhuratë nga vëllai, ***, emigrant në ***, Itali, që në vitin 2004 e në vazhdim; (iii) 66.000 lekë kursime⁵⁷. Pjesa takuese: 100%.

61.2 *Në DV-2009 deklarohe si burim i krijimit:* 4.000 euro dhuratë nga vëllai ***.***, i cili punon në ***, Provinza *** dhe 7.000 euro pakësim i gjendjes *cash*.

61.3 *Me dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR⁵⁸*, Komisionit, konfirmohet blerja e automjetit sipas kontratës për shitblerje automjeti nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2009, lidhur para noterit publik të Dhomës së Noterisë Durrës.

⁵⁵ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2019, sipas së cilës vërtetohet që bashkëshortja znj. ***.*** ka marrë *cash* shumë 30.000 euro nga babai i saj.

⁵⁶ Shkresë përgjigje DRT Tiranë nr. *** prot., datë ***.5.2019; Shkresë përgjigje MF nr. *** prot., datë ***.5.2019.

⁵⁷ Sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit, dërguar me *email*-in e datës ***.4.2019, f. 20.

⁵⁸ Shkresa me nr.***, dt. ***.2.2018.

61.4 Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave në shumën 900.000 lekë, të deklaruara si të ardhura nga zgjidhja e martesës, kjo çështje është trajtuar më lart në këtë ankim.

61.5 Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për vlerën 4.000 euro, është deklaruar në DV-2009 si dhuratë nga vëllai z. ***.***. Për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për dhurimin e shumës 4.000 euro, subjekti ka paraqitur dokumentacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Itali, që dokumenton të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit për periudhën ***.4.2009 - ***.9.2018. Bazuar në këtë dokumentacion rezulton se të ardhurat e realizuara nga vëllai i subjektit për vitin 2009⁵⁹ janë në shumën totale 4.204,20 euro⁶⁰.

61.6 Sa më lart analizuar, rezulton se shuma që i është dhuruar subjektit nga vëllai i tij në vlerën 4.000 euro zë rreth 95% të të ardhurave të ligjshme të realizuara nga ky i fundit në shtetin italian, për vitin 2009. Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, ky fakt e bën të diskutueshme aftësinë financiare të dhuruesit, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumën e deklaruar prej 4.000 euro, konsideruar faktin që me diferencën e mbetur prej 204,20 euro nga të ardhurat e përfituara në vitin përkatës, vëllait të subjektit të rivlerësimit i është dashur të mbulojë së paku shpenzimet e jetesës për atë vit.

61.7 **Në rast se bazuar në këtë ankim, nga ana e Kolegjit do të vendoset të kryhet një analizë e re financiare**, nëse nuk do të konsideroheshin të ligjshme të ardhurat e deklaruara si dhuratë, ky fakt do të ndikonte në justifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

II.B. Vlerësimi profesional

62. Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit kushtetues, kreut VI të ligjit nr. 84/2016 dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, të tilla që për nga provueshmëria e tyre sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, i kanë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën.
63. Referuar rezultateve të hetimit administrativ dhe atyre pas rihapjes së tij⁶¹, këto gjetje dhe mangësi, brenda vlerësimit të këtij kriteri, lidhen si me aftësitë profesionale të subjektit, ashtu dhe me konfliktin e interesit faktik apo atij në dukje, gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar.
64. Nga çështjet e shortuara për rivlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 43/2 të ligjit nr. 84/2016, për tri prej tyre (të emërtuara II/1, II/2 dhe II/4), fillimisht Komisioni ka konstatuar tejkalime në afatet e gjykimit, si dhe, në një rast, vonesë të dorëzimit të dosjes së përfunduar, por pas kalimit të barrë së provës, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni i ka konsideruar bindëse.
65. Komisioni, bazuar në nenet 49 - 50, të ligjit nr. 84/2016, mbështetur edhe në rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë dhe indiciet nga denoncimet e publikut, kryesisht e ka shtrirë hetimin dhe në çështjet e gjykuara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatorit të çështjes dhe të anëtarit të trupit gjykues, gjatë viteve 2014 - 2018⁶², me qëllim hetimin e rrethanave, që sipas ligjit konsiderohen konflikt interesi. Për këtë arsye, Komisioni ka analizuar edhe të dhënat e

⁵⁹ Vit në të cilin i ka dhuruar subjektit shumën 4.000 euro.

⁶⁰ Subjekti ka sqaruar në përgjigjet e datës 19.10.2018 se vëllai im, ***.***, gjatë vitit 2009, nuk ishte pajisur ende me leje qëndrimi në Itali.

⁶¹ Në datë 2.5.2019, Komisioni me vendimin nr. 4, pas vlerësimit të shpjegimeve të dërguara nga subjekti të datës 16.4.2019, ka vendosur rihapjen e hetimit, duke vijuar me hetime të mëtejshme shtesë për kriterin e pasurisë dhe atë të aftësive profesionale. Në mënyrë të detajuar, referohuni edhe në aneksin nr. 1 të rezultateve të hetimit.

⁶² Për më tepër referohuni rezultateve të hetimit, aneksi 1.

publikuara nga faqja zyrtare e Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë, si dhe ka administruar prova nga kjo gjykatë⁶³.

66. Nga vlerësimi i këtyre rasteve, Komisioni ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të funksionit, mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale me të cilat, si subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, kanë pasur marrëdhënie kontraktuale, shitblerje të pasurive të paluajtshme; si dhe (ii) subjekti i rivlerësimit mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit apo atij në dukje, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale, administratën qendrore e vendore të tatim-taksave⁶⁴, në të cilat personi i lidhur me të, bashkëshortja, ka ushtruar funksione në rolin drejtues dhe jo vetëm.
67. Për faktet dhe rrethanat e mësipërme, Komisioni ka administruar edhe një Opinion (të dytë, pas atij për kriterin e pasurisë), nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e aneksit të Kushtetutës (bashkëlidhur ankimit). Sipas këtij Opinioni, i cili në kuptim të nenit 49, pika 11, e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet edhe si një përfundim i dhënë për rrethanën, çështjen konkrete, trajtohet fakti se: (i) subjekti i rivlerësimit duket se nuk është mjaftueshëm i ndjeshëm mbi mundësinë e konfliktit të interesit në dukje, për shkak të mundësisë së ndërhyrjeve midis detyrës dhe funksionit të tij me atë të bashkëshortes së tij, si dhe (ii) në shumë çështje duket sikur subjekti nuk ka vepruar në një mënyrë të duhur me konfliktin e interesit në dukje, duke arritur kështu në konkluzionin se duhen marrë në konsideratë, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit, dhe siç mund të jetë rasti, vlerësimi nëse neni 61/5, i ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim.

Lidhur me konfliktin e interesit (rasti “**” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.)**

68. Nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimi në cilësinë e relatorit të trupit gjykues, me vendimin nr. ***, datë ***.3.2017, ka gjykuar çështjen me palë ankuese, paditës shoqëria tregtare “****” sh.p.k., dhe palë e paditur Bashkia Kamëz, me objekt padie *“Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të ... urdhër zhdëmtimi... për sa i përket detyrimit për ndalimin e shumës prej 1.825.471 lekë së titullit ekzekutiv ndaj paditësit ...”*.

68.1 Në këtë rast, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: (i) ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, (ii) pranimin pjesërisht të padisë dhe (iii) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit, për sa i përket detyrimit për ndalimin e shumës prej 1.825.471 lekë.

68.2 Ndërkohë, nga rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, të pasqyruara më lart edhe në këtë ankim, rezulton se në vitin 2015, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.10.2015, administratori i kësaj shoqërie, z. ***.***, ka blerë apartamentin në pronësi të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në shumën e 110.000 eurove.

68.3 Për këtë rast, Komisioni ka kërkuar edhe një opinion ligjor nga ana e ILDKPKI-së, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019, ky institucion ka arritur në përfundimin se *“...rezulton e provuar, që subjekti i rivlerësimi z. K. Selita, në lidhje me*

⁶³ Referuar rezultateve të hetimit administrativ të datës 28.3.2019, Komisioni me anë të shkresave nr. *** prot., datë ***.2.2019 dhe nr. *** prot., datë ***.2.2019, ka kërkuar dhe administruar nga Gjykata Administrative e Apelit, dosjet për disa prej çështjeve gjyqësore (2014-2018).

⁶⁴ Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, znj. ***.***, për vitet 2010-2019, ka mbajtur këto funksione: 2010-tetor 2013, Zëvendësdirjtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe nga tetori 2013, Drejtor Rajonal në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Në vitin 2014 ka mbajtur funksionin e Drejtorit në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Në vitin 2015 ka mbajtur funksionin e Drejtorit Rajonal në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe në vitin 2016, Drejtor pranë kësaj Drejtorie. Për vitin 2017 - shkurt 2019 ka mbajtur funksionin e Drejtorit në Drejtorinë e Apelitit Tatimor dhe si anëtare e Komisionit të Shqyrtimit të Apelitit Tatimor.

gjykimin dhe vendimmarrjen e kësaj çështjeje, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesave dhe të papajtueshmërisë së funksionit publik”.

68.4 Për rivlerësimin e këtij rasti, Komisioni ka arsyetuar se “... në konsideratë të fakteve: i) se në kohën e gjykimit ka rezultuar përmbushja e të drejtave dhe e detyrimeve sipas kontratës noteriale...; ii) se kjo pasuri ishte rivlerësuar dhe po ashtu ishte shitur pas tre muajve nga pala blerëse me një çmim më të lartë; iii) se nga provat e paraqitura nga subjekti, kontratat e ngjashme me çmime të përafërta tregojnë se nuk ka një çmim preferencial; iv) se në lidhje me vendimmarrjen kjo gjykatë e ka pranuar pjesërisht këtë padi; v) se provat e paraqitura nga subjekti, vendimet e Gjykatës së Lartë, si dhe Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt padie të njëjtë, tregojnë se është mbajtur i njëjti qëndrim” ... në vlerësimin në tërësor të kësaj çështjeje, trupi gjykues çmon se faktet dhe rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit.⁶⁵”

69. Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i mësipërm i Komisionit nuk jep përgjigje nëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit, faktit të interesit apo jo, në referencë edhe të nenit 33/5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Si dhe sa ndikon rëndësia e kësaj rrethane në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke e vlerësuar në harmoni me mangësitë dhe problematikat e tjera të konstatuara. Faktet e analizuara në arsyetimin e Komisionit, nuk përjashtojnë dijeninë e subjektit të një rrethane të tillë, marrëdhënien kontraktuale me bazë interesi pasuror të personit të lidhur, dhe detyrimin e tij për të marrë masa në kushtet e nenit 72-73 të KPr. Civile, me qëllim shmangien në çdo rast të rrethanave apo arsyeve serioze mbi paanshmërinë e tij.

70. Nga analizimi i akteve në dosje, rezulton se rasti i mësipërm nuk është i vetmi. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes me vendimin nr. ***, datë ***.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka gjykuar çështjen me palë ankuese, paditësi, shoqëria “****” sh.p.k., kundër Komisionit të Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve dhe personi i tretë, bashkimi i operatorëve ekonomikë, shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe shoqëria “****” sh.p.k. Në këtë rast, gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka qenë në favor të palës së tretë.

70.1 Më herët nga ky vendim, rezulton se subjekti i rivlerësimit në vitin 2010, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2010, ka blerë apartamentin në Shëngjin, Lezhë për çmimin 2.000.000 lekë, nga shoqëria “****” sh.p.k., me pronar të vetëm, shtetasin ***.***.

70.2 Më pas në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja ***.***, me anë të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2015, kanë blerë nga shtetasi ***.*** dhe bashkëshortja e tij, apartamentin në rr. “****.***” Tiranë, për vlerën 177.370 ruro. Ndërsa në vitin 2016, në të njëjtën adresë, nga ky shtetas kanë blerë apartamentin shtesë dhe garazh, për shumën totale 70.000 euro.

71. Komisioneri Publik konstaton se ky rast nuk është hetuar dhe trajtuar nga ana e Komisionit, megjithëse merr rëndësi si për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, ashtu dhe në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, apo vlerësimit tërësor të çështjes. Komisioneri Publik e çmon të nevojshme që ky rast të trajtohet nga juridiksioni kontrollues i Kolegjit, duke qenë se hetimi dhe vlerësimi i Komisionit ka munguar. Parë kjo, për të dyja rastet e sipërtajtuara si nevojë për vlerësimin nëse subjekti, në cilësinë e relatorit të çështjes gjyqësore, ka gjykuar dhe dhënë vendim nën praninë apo influencën e interesave private të tij apo personit të lidhur me të.

⁶⁵ Pika 2.27 e Vendimit.

Lidhur me konfliktin e interesit në dukje

72. Sikurse parashtruam edhe më sipër, pjesë e hetimit administrativ të Komisionit kanë qenë edhe ato raste në të cilat subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me palë procedurale, administratën qendrore e vendore të tatim-taksave, në të cilat personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka ushtruar funksione në rolin drejtues dhe jo vetëm.

72.1 Nga ky hetim ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit jo në të gjitha rastet ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit në dukje apo i ka marrë me vonesë ato (çështja me palë Federata Shqiptare e Judos, shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****.***”, “**** Bank” etj.⁶⁶). Sikurse ka vepruar në raste të tjera, në zbatim të detyrimeve të K. Pr. Civile.

72.2 Pas rihapjes së hetimit administrativ, si shkak edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit⁶⁷, mbi pozicionet e punës së bashkëshortes së tij në raport me aktet/veprimet administrative të administratës së tatim-taksave, të gjykuara apo që priten të gjykohen e në të cilat subjekti është në cilësinë e relatorit të çështjes apo të anëtarit të trupit gjykues, Komisioni së bashku me shpjegimet e subjektit ka administruar prova dhe akte të ndryshme, përfshirë dhe nga administrata tatimore.

72.3 Në përfundim të sa më sipër, për konfliktin e interesit dhe atij në dukje, shumica e trupit gjykues e Komisionit, pasi ka trajtuar rastet e mësipërme në kuadër të detyrimit të subjektit sipas dispozitave të K. Pr. Civile, ligjit nr. 9367/2005, për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në referencë të jurisprudencës të GJEDNJ-së, mbi vlerësimin e paanshmërisë së subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: *“në asnjë rast nuk u provua se subjekti kishte gjykuar çështje që mund të lidheshin me detyrën që kishte ushtruar bashkëshortja... subjekti ka përmbushur kërkesat e nenit 72-73 të K. Pr. Civile... dhe se ... ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmëri në gjykim”*.

73. **Komisioneri Publik** çmon se përfundimi i shumicës së trupit gjykues të Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve apo vlerësim tërësor të çështjes, duke marrë në konsideratë dhe mangësitë e vërejtura për kriterin e pasurisë, çmoj se aplikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret nuk është plotësisht i bazuar.

73.1 Duke analizuar dorëheqjet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përmbajtja e tyre, miratimi dhe refuzimi, krahasuar me rastet e detajuara në aneksin 1 të rezultateve të hetimit, konstatohet se qëndrimi dhe sjellja e subjektit për të shmangur çdo rrethanë faktike të konfliktit të interesit apo atij në dukje, jo gjithnjë ka qenë e duhura dhe konstante, për disa raste ka qenë e vonuar dhe në disa raste ka munguar.

73.2 Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për të kundërtën e barrës së provës, lidhur me aneksin 1 të rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, argumenton mbi bazën e precedentit të mosmiratimit nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, të një rasti dorëheqje të tij nga gjykimi i një çështje me palë kompaninë “****” dhe Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në të cilën personi i lidhur, bashkëshortja, ka mbajtur detyrën e Drejtorit. Sipas kësaj kërkesë, konstatohet se është vetë subjekti që, pasi referon se “aktbllokimi i llogarive bankare nuk është pjesë e dosjes”, e vlerëson paraqitjen e saj për të shmangur çdo perceptim mbi paanshmërinë e gjykimit.

73.3 Ndërkohë që ky kujdes për të shmangur këtë perceptim, në rastet kur subjekti rezulton relator i çështjes dhe merr dijeni më herët nga anëtarët e trupit, për konfliktin gjyqësor dhe përmbajtjen e dosjes, në disa raste ka munguar apo ka qenë i vonuar, qoftë edhe formalisht si

⁶⁶ Për më tepër, referohuni në aneksin nr.1 të rezultateve të hetimit.

⁶⁷ Për më tepër referohuni në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dt. 16.4.2019, përfshirë përgjigjet për çështjet gjyqësore në aneksin nr. 1 të rezultateve të hetimit.

përgjegjësi e subjektit në zbatim të dispozitave të K. Pr. Civile (si p.sh., në çështjen me subjektin “***.***.***” sh.p.k., “***”, “***.***...” sh.a., “*** Bank” sh.a. etj.⁶⁸).

73.4 Nga një vlerësim në tërësi të çështjes, konstatohet se rastet e mësipërme nuk janë të shkëputura, në raport me qëndrimin e subjektit për të shmangur situata të konfliktit, faktit të interesit apo atij në dukje, parë kjo edhe me rëndësinë që ka besimi dhe perceptimi i publikut në pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë që magjistrati duhet të kujdeset të reflektojë. Ky detyrim, përveç se gjen rregullim specifik në dispozitat përkatëse të kreut V të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin nr. 9367/2005, mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, ka gjetur vend edhe në ligjin e posaçëm nr. 96/2016, për statusin e magistratëve, nenet 3⁶⁹, 4⁷⁰ e në vijim të tij.

73.5 Për sa më sipër, referuar edhe në kriteret e vlerësimit sipas nenit 75/4⁷¹ të ligjit nr. 96/2016, rezulton se jo në të gjitha rastet subjekti është kujdesur për shmangien e konfliktit të interesit dhe atij në dukje. Raste në të cilat, në pamje të parë më së paku do të paragykonin paanshmërinë e vendimmarrjes, pasi në to ndërthuret gjykimi i subjektit gjatë procedurave gjyqësore, me vendimmarrjet apo ndikimet e mundshme, të drejtpërdrejta apo të tërthorta për shkak funksioni drejtues, të personit të lidhur me të, bashkëshortes.

73.6 Një situatë e tillë, eventualisht mund të minojë besimin që gjykatat duhet të frymëzojë te shoqëria dhe publiku.

73.7 Për ekzistencën e paanshmërisë, sikurse arsyeton edhe Komisioni, është e vërtetë që praktika gjyqësore ia nënshtron testit subjektiv dhe objektiv, por, sidoqoftë, nuk ka ndarje të drejtë midis paanshmërisë subjektive dhe asaj objektive, pasi sjellja e një gjykatësi jo vetëm që mund të shkaktojë mosbesim në mënyrë objektive, në lidhje me paanshmërinë e mbajtur nga këndvështrimi i vëzhguesit të jashtëm, por gjithashtu mund të shkojë në çështjen e bindjes së tij personale⁷². Gjithsesi, gjykimi dhe vlerësimi duhet të bëhet rast pas rasti. Në këtë drejtim, edhe aparenca merr një rëndësi të caktuar, me fjalë të tjera, “*drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet se bëhet*⁷³”.

Denoncimet nga publiku

74. Në vlerësimin e çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni është ndalur dhe në hetimin e denoncimeve nga publiku (17 të depozituara), në të cilat, ndër të tjera, pretendohen mangësi të subjektit në aftësitë profesionale, lidhur me aftësinë për të gjykuar dhe atë organizative, si vonesa në gjykim, mosnjohim në kohë të palëve etj.
75. Nga analiza e këtyre denoncimeve, konstatohet se jo në të gjitha kanë gjetur trajtim të plotë nga ana e Komisionit apo edhe kur janë trajtuar, sërish përgjigjet e subjektit nuk janë ezauruese për të gjitha çështjet e ngritura. Nga një vlerësim i kujdesshëm i denoncimeve, pretendohen fakte dhe rrethana të cilat mund të marrin rëndësi, në zbatim të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shërbejnë për vlerësimin tërësor të çështjes. Siç mund të jetë denoncimi i paraqitur nga shtetasja ***.***, krahasuar kjo dhe me elemente dhe çështje të ngjashme, të ngritura në denoncimin nga një grup gjyqtarësh, ku sërish na rezulton se Komisioni nuk e ka hetuar plotësisht apo rasti i shtetasit ***.*** etj.

⁶⁸ Për më tepër, referohuni në aneksin 1 të rezultateve të hetimit dhe rezultatet shpesh të hetimit.

⁶⁹ [4. Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces.]

⁷⁰ [2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të Prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit.]

⁷¹ [Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit...]

⁷² Për më tepër, referohuni në vendimin e *Micallef kundër Maltës*, Dhoma e Madhe, tetor 2009.

⁷³ Referohuni, ndër të tjera *De Cubber kundër Belgjikës*, tetor 1984.

76. Për denoncimin e Kantierit të ndërtimit të anijeve (Reparti ushtarak 2010) Pashaliman, Vlorë

76.1 Nga vlerësimi i këtij denoncimi, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, në gjykimin e dy rasteve, me objekt gjykimi marrëdhëniet e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, i paditur Kantieri i ndërtimit të anijeve Vlorë, për fakte dhe rrethana të njëjta, subjekti ka mbajtur qëndrime të ndryshme, sa i takon analizës juridike dhe zgjidhjes së çështjes. Por pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, i ka gjetur bindëse ato për të kundërtën e barrës së provës.

76.2 **Komisioneri Publik** çmon se hetimi dhe vlerësimi i Komisionit në këtë rast, bazuar dhe në përcaktimet e nenit 72 e në vijim të ligjit nr. 96/2016, nuk është shterues dhe bindës. Lidhur me këtë denoncim, sërish mbetet e paqartë nëse subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin standard të interpretimit ligjor, analizimit të jurisprudencës, argumentimit logjik dhe zgjidhjes së drejtë të rasteve të njëjta, parë kjo dhe në raport të kujdesit dhe cenimit ose jo të të drejtave të palëve procedurale. Në këtë drejtim, nga ana e Komisionit nuk rezulton të jetë vlerësuar fakti se midis kërkimit të ankimit të palës së paditur dhe vendimmarrjes së gjykatës, nga zgjidhja përfundimtare e gjykatës, kjo palë ka dalë në situatë më të disfavorshme në aspekt të detyrimit financiar. Kjo është e diskutueshme duke marrë parasysh se vendimmarrja është bërë në dhomë këshillimi dhe objekt gjykimi ka qenë vetëm ankimi dhe pretendimet e palës së paditur.

76.3 Në kuptim të nenit 456 të K. Pr. Civile dhe nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, kjo vendimmarrje nuk është kërkuar nga pala paditëse, rrjedhimisht në zbatim të nenit 459 të këtij Kodi, çdo pretendim i kësaj pale mbi të drejtat që kishte fituar nga vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, do duhet të ishin konsideruar që ishte hequr dorë dhe kishin rënë në dekadencë. Në këtë drejtim, mbajmë në konsideratë edhe praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 3/2009⁷⁴.

Për denoncimin e paraqitur nga një grup gjyqtarësh⁷⁵

77. Ky denoncim, i cili sikurse parashtruam, rezulton të mos jetë hetuar plotësisht nga Komisioni për të gjitha elementet dhe çështjet e paraqitura në të, përveç të tjerash, denoncon vendimmarrjen e subjektit në çështjen gjyqësore që i përket vendimit nr. *** (***) datë ***.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me palë paditëse, ***.*** kundër *Presidentit të Republikës*.

77.1 Nga vlerësimi i këtij rasti, Komisioni ka konkluduar se ekzistojnë mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, pasi ka vlerësuar:

- (i) Ekzistencën e mospërputhjeve mes kërkimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës, pasi paditësi nuk ka kërkuar që t’i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që e detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim referuar KLP) të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori;

⁷⁴[..Fryma që karakterizon Kodin e Procedurës Civile është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform nenit 6 të K. Pr. Civile, gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme, duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet... Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë ultra petita partium”.]

⁷⁵ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë ***.2.2019.

(ii) Rolin aktiv të gjykatës/subjektit, lidhur me saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke detyruar KLP-në të bëjë emërimin e paditësit si prokuror;

(iii) Tejkalimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces; dhe

(iv) Mosarsyetimin e rolit dhe kompetencave të palës ndërgjyqëse/KLP-së, në momentin e zëvendësimit të saj, sipas ligjit nr. 96/2016.

- 78. Komisioneri Publik** e sheh të nevojshme që, para së gjithash, lidhur me këtë çështje, të ripërsëritë qëndrimin e mbajtur në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 84/2018 të Komisionit, në rastet kur në dispozitivin e këtij të fundit gjen zbatim neni 59/4, i ligjit nr. 84/2016, sikurse është edhe rasti konkret. Ndalimi i parashikuar në nenin 59/4 të ligjit nuk vepron mbi të drejtën e ankimit që i njihet Komisionerit Publik nga neni F, pika 2 e aneksit kushtetues, si për pjesë të veçanta të ankimit, ashtu edhe në tërësi të tij. Është vetë kjo dispozitë, ajo që parashikon dhe kufizimin e së drejtës së ankimit të Komisionerit Publik, vetëm në rastet kur Komisioni ka vendosur bazuar në nenin E, paragrafi 2⁷⁶ të këtij aneksi dhe/ose neni 58, pika 1, germa “b”⁷⁷ e ligjit nr. 84/2016, vendimmarrje kjo e ndryshme nga ajo sipërcituar.
- 79.** Duke ju rikthyer rastit konkret, Komisioneri Publik vlerëson se në marrjen e vendimit për transferimin e çështjes tek organi kompetent për inspektim, Komisioni nuk ka vlerësuar paraprakisht duke arsyetuar në mënyrë shteruese, nëse mangësitë profesionale të konstatuara duhen veçuar dhe t’i shkojnë organit kompetent inspektues apo ato i shërbejnë dhe marrin rëndësi për vlerësimin në tërësi të çështjes, për qëllim të procesit të rivlerësimit, që, së bashku me problematikat dhe mangësitë e tjera, mund të sjellin një rezultat të ndryshëm për subjektin e rivlerësimit.

79.1 Bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga neni E i aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016, konstatojmë se përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për të kundërtën e barrës së provës për këtë çështje, nuk janë bindëse, të cilat, për qëllim të procesit të rivlerësimit, duhen parë lidhur dhe me njohuritë dhe aftësinë e përgjithshme të subjektit për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, si dhe analizimit të jurisprudencës së aplikueshme, të gjitha këto elemente vlerësuese për kriterin e aftësive profesionale.

79.2 Në shpjegimet e tij, subjekti argumenton se: *“Saktësimi i pikës 3 të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ka qenë i diktuar nga ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që ndodhën, pas zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë dhe para përfundimit të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, e që sollën si pasojë kalimin e kompetencës së emërimit të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nga Presidenti i Republikës të Këshilli i Lartë i Prokurorisë (neni 159/2 germa “c”, i ligjit nr. 115/2016)”. Sipas subjektit, saktësimi i dispozitivit nuk është parë lidhur me saktësimet e tjera që vijnë nga ligji nr. 96/2016.*

79.3 Konstatojmë se referenca ligjore që subjekti i rivlerësimit bën në këtë rast, neni 159/2, germa “c” i ligjit nr. 115/2016, është i gabuar, pasi kjo dispozitë është shfuqizuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 41/2017, ndërkohë që vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit është marrë në shkurt 2019. Kjo referencë e gabuar ligjore, suksedimi procedural nga Presidenti i Republikës të KLP bazuar në nenin 199/2⁷⁸ të K. Pr. Civile, si dhe parimi i vazhdimësisë institucionale e ligjore shoqërojnë gjithë argumentimin e subjektit.

79.4 Përgjigjja e subjektit nuk sqaron faktin se, megjithëse objekti i gjykimit ka vijuar i njëjtë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë edhe në atë të Apelit, pra në aspektin material e

⁷⁶ Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë [...]

⁷⁷ Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit... b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit [...]

⁷⁸ Neni 199, “Kalimi procedural” [Kur pala që është person juridik mbaron, çështja vazhdon nga ose kundër personit juridik a fizik, të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimet e personit juridik që ka mbaruar.]

atë procedural, kufijtë e shqyrtimit të kësaj çështje nuk kanë ndryshuar, përtej kërkimeve të ankuesit, Presidenti i Republikës, referuar dispozitës urdhëruese të nenit 465⁷⁹ të K. Pr. Civile, legjitimiteti pasiv i ankuesit/palës së paditur është kaluar tek KLP-ja.

80. Duke përfunduar, për kriterin e aftësive profesionale, Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se përfundimi i Komisionit është i cenueshëm, pasi bazohet në një hetim të pamjaftueshëm dhe interpretim jo të drejtë ligjor të fakteve. Për këtë kriter, dhe jo vetëm, para së gjithash, vlen të theksohet se vlerësimi duhet parë dhe analizuar në këndvështrim të raportit të ngushtë që ka procesi i rivlerësimit në rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, qëllim i përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës. Si një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme, proporcionalisht e balancuar në raport me nevojën dhe synimin e kërkuar nga kjo dispozitë, marzhi i vlerësimit në këtë rast është dhe duhet të jetë më i gjerë, përfshirë dhe vlerësimin në tërësi të procedurave, fakteve dhe rrethanave me vlerë përcaktuese për të tria kriteret, përpara se të arrihet në përfundimin e konfirmimit në detyrë të subjektit.

III. Kërkimi i ankimit

81. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;
82. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;
83. Bazuar në kërkesat e nenit Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;
84. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:
- Ndryshimin
 - ose
 - Lënien në fuqi të vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

⁷⁹ Neni 465, "Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel" (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017): [1. Gjykata e apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit. 2. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitatat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë. 3. Me kërkesë të palëve ose kryesisht, Gjykata e Apelit riçel pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor. 4. Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementët e padisë, me përjashtim të kërkimit për shpenzimet e gjykimit në apel.]

1. Rekomandim për ushtrim ankimi i ONM-së, nr. 900/1 prot., datë 24.7.2019;
2. Opinion i vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, nr. 147 prot., datë 7.2.2019;
3. Opinion i vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, nr.147/1 prot., datë 31.5.2019.